



Agjencia për Mbështetjen
e Shoqërisë Civile

RAPORT I ZGJERUAR VJETOR

2016



Shifra më e mëdha e Projektesh të implementuara në bashki të ndryshme



Indikator	2015	2016	2017
1.1. Numri i Projektesh të implementuara	10	10	10
1.2. Vlerë e Projektesh të implementuara	10000	10000	10000
1.3. Numri i bashkive të cilat kanë implementuar	10	10	10
1.4. Numri i bashkive të cilat kanë aplikuar	10	10	10
1.5. Numri i bashkive të cilat kanë marrë	10	10	10
1.6. Numri i bashkive të cilat kanë marrë	10	10	10
1.7. Numri i bashkive të cilat kanë marrë	10	10	10
1.8. Numri i bashkive të cilat kanë marrë	10	10	10
1.9. Numri i bashkive të cilat kanë marrë	10	10	10
1.10. Numri i bashkive të cilat kanë marrë	10	10	10



amshc

Agjencia për Mbështetjen
e Shoqërisë Civile

RAPORT MBI VEPRIMTARINË E AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE GJATË VITIT 2016

Tiranë, Janar 2017

Tabela e përmbajtjes:

KAPITULLI I

Vështrim i përgjithshëm 2

KAPITULLI II

Zbatimi i ligjit për transparencën, ligjit për të drejtën e informimit 5

*Raport monitorimi të aktiviteteve në kuadër të implementimit të projekteve fituese
për projekt propozime të Thirrjes Nr. 9* 8

*Analiza dhe statistika të shpërndarjes së granteve sipas fushave prioritarë
si dhe shtrirjes territoriale* 11

KAPITULLI III

Monitorim vlerësimi i treguesve buxhetorë për vitin 2016 17

Programi “Mbështetje për Shoqërinë Civile” 20

Ecuria e disbursimeve të granteve financiare 23

KAPITULLI IV

Aktivitetet kryesore të AMSHC-së për vitin 2016 26

KAPITULLI I

AGJENCIA PER MBESHTETJEN E SHOQERISE CIVILE

Vështrim i përgjithshëm

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, është një ent publik, buxhetor krijuar me Ligjin me nr. 10093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.

AMSHC-ja është krijuar me qëllimin për të asistuar me Mbështetje Financiare dhe Teknike Shoqërinë Civile në vend duke qenë e përkushtuar të promovojë, mbështesë dhe mbrojë parimet e dinjitetit njerëzor, lirisë, barazisë, mos-diskriminimit, sundimit të ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut, transparencës dhe profesionalizmit.

Një shoqëri civile aktive, e fuqishme dhe gjithë përfshirëse mund të luajë një rol të rëndësishëm për zbatimin në praktikë të këtyre parimeve. Ajo është gjithashtu një komponent thelbësor i çdo demokracie funksionale.

Duke artikuluar shqetësimet e qytetarëve, organizatat e shoqërisë civile, si subjekte jo-shtetërorë, struktura jo-fitimprurëse, në të cilat njerëzit organizohen të ndjekin objektivat dhe idealet e përbashkëta, duhet të jenë gjithnjë e më shumë aktive për çështje publike si dhe të angazhohen në iniciativa që nxisin pluralizmin dhe pjesëmarrjen në demokraci.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në kuadër të politikës së fuqizimit të shoqërisë civile, është përqendruar në stimulimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe gjithë përfshirëse.

Kjo reflektohet në përpjekjet për krijimin e një mjedisi që është i favorshëm për aktivitetet e shoqërisë civile dhe ndërtimin e kapaciteteve të OJF-ve për të qenë aktorë të efektshëm, të përgjegjshëm dhe të pavarur, nëpërmjet formalizmit të procedurave transparente dhe jo-diskriminuese të regjistrimit, veprimtarisë së lirë dhe të pavarur, si dhe bashkëpunimit midis qytetarëve etj.

Shoqëria civile, duke pasur struktura të përshtatshme dhe mekanizma për bashkëpunim me AMSHC-në dhe institucionet e tjera publike, si dhe fluks të lirë, të qartë dhe të arritshme të informacionit mbi çështjet e interesit publik përmes mekanizmave të qëndrueshme dhe të strukturuar, rrit autonominë e saj, atë të përfaqësimit dhe të llogaridhënies, duke forcuar bazën e organizatave sipas standardeve më të larta të qeverisjes së brendshme, nëpërmjet përfshirjes së strukturave demokratike, monitorimit dhe vlerësimit, menaxhimit financiar, transparencës, informimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë.

ORGANET DHE FUNKSIONET E INSTITUCIONIT

Agjencia Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile është krijuar me Ligjin nr. 10093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” dhe ka si mision të saj, nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma civile, në të mirë dhe në interes të publikut.

Për përmbushjen e këtij misioni, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile ka si detyrë të saj funksionale që të ofrojë asistencë financiare dhe teknike për programet që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse; bashkëpunimin ndër-sektorial e ndërkombëtar; nismat civile; filantropi; vullnetarizmin e institucioneve demokratike të shoqërisë civile; si dhe programe të tjera, që lehtësojnë përmbushjen e misionit të saj.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- *nxitjen e bashkëpunimi me OJF-të, që kanë objekt të punës mbikëqyrjen e luftës kundër korrupsionit; luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore e të trajtimit të viktimave të saj; kundër dhunës në familje e kundër dhunës ndaj fëmijëve;*
- *nxitjen e qytetarëve në veprimtari, përfshirja e pjesëmarrja e tyre për zhvillimin e komunitetit;*
- *respektimin e të drejtave të njeriut;*
- *krijimin e konsolidimin e kapaciteteve të shoqërisë civile;*
- *zhvillimin e bashkëpunimit ndër sektorial dhe e bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile;*
- *rritjen e ndikimit publik dhe veprimtarisë së organizatave të shoqërisë civile në vendimmarrje;*
- *zhvillimin e sipërmarrjes shoqërore dhe punësimit në sektorin jofitimprurës;*
- *rritjen e ndikimit të shoqërisë civile në proceset e hartimit dhe të miratimit të politikave publike*
- *përcaktimin e procedurave të zbatueshme për shpërndarjen e fondeve në mbështetje të shoqërisë civile etj.*

KUADRI LIGJOR, ORGANIZIMI STRUKTUROR DHE FUNKSIONIMI I AMSHC-SË

Kuadri ligjor i funksionimit dhe organizimit të punës

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile funksionon dhe mbështet punën e saj duke u bazuar në një paketë të plotë ligjore, si vijon:

- a) Ligji me nr. 10093 datë 09.03.2009 *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”*. Ky ligj, deri më sot nuk ka pësuar asnjë ndryshim.
- b) Vendimi nr. 769 datë 15.07.2009 i Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e statutit të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”*.
- c) Vendimi nr. 789 datë 16.11.2011 të Këshillit të Ministrave *“Për një ndryshim në Vendimin nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”*.
- d) Rregullorja e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, miratuar me vendimin e Bordit Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 20.09.2010.
- e) Rregullorja e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, e azhurnuar në përputhje dhe përshtatje me ndryshimet e parashikuara në Vendimin nr. 789 datë 16.11.2011 të Këshillit të Ministrave *“Për një ndryshim në Vendimin nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”*”. Këto ndryshime janë miratuar me vendimin e Bordit Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 30.11.2011.
- f) Rregullorja *“Mbi procedurat e Financimit me Grante në Mbështetje të Shoqërisë Civile”* të miratuar nga Bordi Mbikëqyrës me Vendimin nr. 1 datë 08.07.2010.
- g) Rregullorja *“Mbi procedurat e Financimit me Grante në Mbështetje të Shoqërisë Civile”*, e ndryshuar me vendimin e Bordit Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 10.03.2011.
- h) Vendimi nr. 1 datë 08.07.2010 i Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, nëpërmjet të cilit janë miratuar:
 - Formati i Aplikimit.
 - Kriteret e Vlerësimit.
 - Kontrata Tip
- i) Udhëzimin nr. 1 datë 29.12.2010 i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile *“Për plotësimin e raporteve financiare dhe kontrollin financiar, për efekt të monitorimit të Projekteve të financuara me Grante nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”*.
- j) Urdhri nr. 161 datë 05.09.2013 i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile *“Për procedurën e administrimit të akteve shkresore, kërkesave/projekt-propozimeve, formimin e dosjeve dhe mënyra e qarkullimit të tyre në AMSHC”*.

KAPITULLI II

Zbatimi i ligjit për transparencën, ligjit për të drejtën e informimit

Në kuadër të raportimit periodik mbi ecurinë e zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit të strategjisë ndër-sektoriale kundër korrupsionit 2015-2020, agjencia për mbështetjen e shoqërisë civile ka zbatuar e raportuar masat e parashikuara në plan si më poshte:

A. Hartimi i Programeve të Transparencës sipas ligjit të ri për të drejtën e informimit

REALIZUAR NGA AMSHC:

Zbatimi i Ligjit "PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT". Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" është përgatitur programi i transparencës për Agjencinë e Mbështetjes së Shoqërisë Civile. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimitarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" (LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës AMSHC ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. Autoriteti Publik do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së. Informacioni i bërë publik synon të bëjë transparencën e veprimitarisë së punës së AMSHC-së, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.amshc.gov.al si dhe në mjediset e pritjes së publikut.

Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë. Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje.

Faqja zyrtare e AMSHC-së është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

B. Zbatimi i plotë i ligjit për konsultimin publik

Në kuadër të Ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" me objekt si më poshtë vijon:

1. Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve,

- projektdokumente strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik.
2. Ky ligj përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike.
 3. Ky ligj synon nxitjen e transparencës, të përgjegjshmërisë dhe integritetit të autoriteteve publike.

AMSHC-ja ka marre masat e nevojshme për zbatimin e këtij ligji për të gjithë veprimtarinë e AMSHC-së, duke e kthyer procesin e konsultimit publik për çështje dhe vendime të caktuara si element kyç dhe thelbësor të strategjisë së punës së saj. Ne vijim te zbatimit të Ligjit, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) zhvilloi takime konsultative me përfaqësues të Shoqërisë Civile në disa qytete të vendit, me qëllim marrjen e komenteve / sugjerimeve dhe ndihmesës të tyre mbi përcaktimin e prioritetëve të Thirrjes Nr. 9 si edhe të mënyrës së realizimit të saj.

Më konkretisht përmendim:

- ❖ *Takimet konsultative për hartimin e një strategjie afatmesme dhe afatgjatë si dhe Fushat Prioritare, për të pëmbushur misionin e saj **duke patur synimin e një mbulimi sa më të gjerë gjeografik në: Tiranë, Shkodër, Pogradec, Vlorë, Kukës dhe Korçë.***
Në këtë proces Agjencia ka përfshirë aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile si OJF, nisma qytetare, institucione akademike, qendra kërkimore, fondacione, partnerë ndërkombëtarë, pushtetin qendror dhe lokal etj.
- ❖ *Këto takime u organizuan për të qenë një instrument i rëndësishëm i dialogut si dhe rritjes së transparencës midis shoqërisë civile dhe institucioneve.*
Për t'ju lehtësuar dhënien e opinioneve vetë tyre, j'u është shpërndarë në të gjitha takimet e realizuara paraprakisht një pyetësor i shkurtër të cilin e kanë pasur dhe online në website-in tonë: www.amshc.gov.al

Duke u bazur në pyetësorët e plotësuar nga përfaqësuesit e shoqërisë civile në të gjitha takimet në tërësi, të plotësuara (e grumbulluar nga ne) qoftë manualisht prej tyre, si edhe ato të dorëzuara elektronikisht në adresën info@amshc.gov.al; apo qoftë dhe nga diskutimet pjesëmarrësve në të pestë takimet.

Referuar problematikave kryesore të ngritura e të evidentuara nga aktorët e shoqërisë civile gjatë takimeve u identifikuan **fushat prioritare**; të ngritura e të evidentuara nga vetë aktorët e shoqërisë civile.

- ❖ *Takimet u zhvilluan edhe në kuadër të procesit e përzgjedhjes së kandidatëve për Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC)*
- ❖ *Takime konsultative për Thirrjen Nr. 9 për Projekt-Propozime (Misioni dhe qëllimi kryesor i AMSHCsë) në fazën e sapo shpalljes së këtyre Thirrjeve, duke dashur të jetë në koherencë me problematikën e shoqërisë civile, ka ndërmarrë Takime Konsultative për të thithur sugjerimet dhe problematiket lidhur me prioritetet e shoqërisë civile.*

Projektet e financuara nga AMSHC për periudhën Janar – Dhjetor 2016, që targetojnë korrupsionin, transparencën dhe përfshirjen e qytetarëve në politikëbërje nëpërmjet monitorimit

Bordi Mbikqyrës i AMSHC- së me Vendim Nr.2, dt.25.04.2016, Nr.prot 151/1 vendosi për financimin e 11 projekteve të OSHC-ve në vlerë totale leke 21,000,000 për luftën kundër korrupsionit; transparencën dhe përfshirjen e qytetarëve në politikëbërje nëpërmjet monitorimit.

1	Qendra ORBIS	2,500,000
2	Instituti i Studimeve Politike	800,000
3	Millennial Hope	1,200,000
4	Instituti për Rinovimin e Politikave Sociale (IRPS)	2,000,000
5	Fondacioni "Moisiu"	1,000,000
6	Qendra "Instituti për Reforma Sociale"	2,500,000
7	Qendra Burimore e Alternativave të Zhvillimit (DARC)	2,500,000
8	Intelektualët e Rinj, Shpresë	600,000
9	Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA)	3,900,000
10	Qendra IMPAKT	2,000,000
11	Qendra për Bashkëpunim dhe Zhvillim Rajonal	2,000,000
	TOTAL (Lekë)	21,000,000

Raport monitorimi të aktiviteteve në kuadër të implementimit të projekteve fituese për projekt propozime të Thirrjes Nr. 9, për periudhën 26.03.2016 - 31.12.2016

Llojet e aktiviteteve sipas Prioritetve Strategjike i grupojmë si më poshtë tabela:

<p>1. Mbështetje e nismave që ndikojnë në përmirësimin e kushteve të grupeve në nevojë dhe personave me aftësi të kufizuar, përfshirë këtu mbështetjen me infrastrukturë ndihmëse, fuqizimin e kapaciteteve profesionale dhe nxitjen e zhvillimit të shërbimeve nga operatorët, sensibilizimin e shoqërisë dhe rritjen e ndjeshmërisë ndaj tyre;</p>	<p>2. Evidentimi i nismave të qeverisjes së mirë përfshi këtu ndikimin e shoqërisë civile dhe pjesëmarrje në zhvillimin e politikave dhe përmirësimet në sistemet e ofrimit të shërbimeve me në qendër qytetarin, luftën ndaj korrupsionit përmes inovacionit dhe modernizimit të sistemeve pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të qyterarëve dhe shoqërisë civile në performancën e shërbimeve dhe politikë-bërje;</p>
<p>Qëllimi/Llojet e Aktiviteteve: Ofrimi i mbështetjes që ndikon në përmirësimin e kushteve, promovimin dhe integrimin e të rinjve me probleme sociale duke ngitur dhe fuqizuar kapacitetet e tyre përmes integritit dhe punësimit si dhe nismave të sipërmarrjes së lirë; Zhvillimi i potencialive fizik, gjuhësor, mendor dhe emocional, zhvillimin e aftësive kognitive dhe sociale, të të shprehurit dhe të autonomisë, të sigurojë rehabilitimin dhe edukimin e fëmijëve me sindromën Down; etj</p>	<p>Qëllimi/Llojet e Aktiviteteve: Implementimi i këtij prioriteti orientohet për nga përmirësimi i kapaciteteve të organizatave jofitimprurëse për të rritur cilësinë dhe zhvillimin social të vendit. Qëllimi është analizimi e diskutimi mbi problematikat madhore të demokracisë dhe të ndërtimit të shtetit në vendin tonë, dhënien e sugjerimeve të ndryshme në formën publike dhe zyrtare për median, qytetarët, institucionet dhe aktorët politikë. .</p>
<p>Vizibiliteti:</p> <p>Fletë- Palosje 4.070 copë Postera 3500 copë Baner 3 copë Bluza 700 copë Broshura Informuese550 copë</p>	<p>Vizibiliteti:</p> <p>Fletë- Palosje.....1100 copë Postera.....900 copë Baner.....2 copë</p>

3. Mbështetja e nismave dhe reformave që përmirësojnë mjedisin mundësues të shoqërisë civile, fuqizimi e rolit të organizatave të shoqërisë civile në të dhe zhvillimin e politikave prioritare dhe sektoriale, krijimi i kushteve për sisteme që rrisin dhe lehtësojnë një mjedis mundësues, përfshirë rritjen e rolit të shoqërisë civile në komunikimin publik dhe dialogun për zhvillim;

Qëllimi/Llojet e Aktiviteteve:

Krijimi i grupeve të foto- reporterëve të rinj në dy rrethe të Shqipërisë, të cilët do të kenë hapësirën e tyre të përbashkët virtuale prej nga do të raportojnë mbi jetën në qytetet e tyre. Projekti “Rritja e kontributit të studentëve në komunitet” ka si qëllim kryesor aftësimin e studentëve për të identifikuar sfidat e komunitetit ku jetojnë dhe përagtitjen e tyre nëpërmjet trajnimit të përballjes me këto sfida.

Vizibiliteti:

Fletë- Palosje
900 copë
Postera
700 copë
Broshura
300 copë
Revista
1.000 copë
Katalog
300 copë

4. Fuqizimi i barazisë gjinore, luftës kundër diskriminimeve që rrjedhin nga seksi, raca apo bindje të tjera personale;

Qëllimi/Llojet e Aktiviteteve:

Rritja e kapaciteteve profesionale të grave dhe vajzave të pa punësuar që banojnë në periferinë e Tiranës përmes trajnimit profesional: Qëllimi i projektit është të aftësoje grate që të njohin dhe reagojnë ndaj formave të fshehta të diskriminimit dhe dhunes psikologjike e fizike vecanerisht asaj që ushtrohet nga partneret intime.

Vizibiliteti:

Çertifikata Trajnimi.....	100
copë	
Adresë	Zyrtare
1 copë	
Fletë- Palosje.....	11400
copë	
Postera.....	4.900
copë	
Baner.....	2
copë	

<p>5. Fuqizimi i nismave që kanë si objektiv mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e ndërgjegjshmërisë ambientaliste të qytetarëve, kryesisht të rinjve;</p> <p>Qëllimi/Llojet e Aktiviteteve: Ndërgjegjësimi dhe angazhimi i popullësisë vendase mbi rëndësinë e ruajtjes së bimësisë natyrore dhe biodiversitetit të zonës; “Rritja e kontributit të studentëve në komunitet” ka si qëllim kryesor aftësimin e studentëve për të identifikuar sfidat e komunitetit ku jetojnë dhe përagtitjen e tyre nëpërmjet trajnimit të përballjes me këto sfida.</p> <p>Vizibiliteti:</p> <p>Fletë- Palosje 1200 copë Postera 510 copë Broshura 3150 copë</p>	<p>6. Fuqizimi i iniciativave rinore, si edhe lidhjeve me partnerë rajonalë dhe ndërkombëtarë në këtë sektor dhe zhvillimin lokal dhe rajonal të vendit; krijimi i kushteve për biznese sociale dhe aktivitete të tjera me karakter inovativ.</p> <p>Qëllimi/Llojet e Aktiviteteve: Ofrimi i informacionit të detajuar dhe ndërgjegjësimi i të rinjve shqiptarë mbi Zyrën Rajonale për Bashkëpunim Rinor; aftësimi i grave që të njohin dhe reagojnë ndaj formave të fshehta të diskriminimit dhe dhunës psikologjike e fizike veçanërisht asaj që ushtrohet nga partnerët intim; .</p> <p>Vizibiliteti:</p> <p>Poster.....6000 copë Broshura 200 copë Kartolina Informuese.....100 copë</p>
<p>7. Mbështetje nismave kulturore dhe artistike që krijojnë vlerë të shtuar për kontekstin social dhe zhvillimin e sinergjive brenda shoqërisë civile.</p> <p>Qëllimi/Llojet e Aktiviteteve: Krijimi i nje rrjeti midis aktoreve te ndryshem te vleres, fermere, perpunues, shites dhe sherbimeve mbeshtetese nepermjet zhvillimit te trajnimeve te specializuara ne menyre qe te rritet efienca e funksionit teresor te zinxhirit te vleres.</p> <p>Vizibiliteti:</p> <p>Fletë- Palosje.....400 copë Postera.....350 copë</p>	

Analiza dhe statistika të shpërndarjes së granteve sipas fushave prioritarë si dhe shtrirjes territoriale

Fushat prioritarë - Thirrje Nr. 9 të për projekt-propozime:

1. Mbështetje e nismave që ndikojnë në përmirësimin e kushteve të grupeve në nevojë dhe personave me aftësi të kufizuara, përfshirë këtu mbështetjen me infrastrukturë ndihmëse, fuqizimin e kapaciteteve profesionale dhe nxitjen e zhvillimit të shërbimeve nga operatorët, sensibilizimin e shoqërisë dhe rritjen e ndjeshmërisë ndaj tyre;
2. Evidentimi i nismave të qeverisjes së mirë përfshi këtu ndikimin e shoqërisë civile dhe pjesëmarrje në zhvillimin e politikave dhe përmirësimet në sistemet e ofrimit të shërbimeve me në qendër qytetarin, luftën ndaj korrupsionit përmes inovacionit dhe modernizimit të sistemeve pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të qytetarëve dhe shoqërisë civile në performancën e shërbimeve dhe politikë-bërje;
3. Mbështetja e nismave dhe reformave që përmirësojnë mjedisin mundësues të shoqërisë civile, fuqizimi e rolit të organizatave të shoqërisë civile në to dhe zhvillimin e politikave prioritarë dhe sektoriale, krijimi i kushteve për sisteme që rrisin dhe lehtësojnë një mjedis mundësues, përfshirë rritjen e rolit të shoqërisë civile në komunikimin publik dhe dialogun për zhvillim;
4. Fuqizimi i barazisë gjinore, luftës kundër diskriminimeve që rrjedhin nga seksi, raca apo bindje të tjera personale;
5. Fuqizimi i nismave që kanë si objekt mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e ndërgjegjshmërisë ambientaliste të qytetarëve, kryesisht të rinjve;
6. Fuqizimi i iniciativave rinore, si edhe lidhjeve me partnerë rajonalë dhe ndërkombëtarë në këtë sektor dhe zhvillimin lokal dhe rajonal të vendit; krijimi i kushteve për biznese sociale dhe aktivitete të tjera me karakter inovativ.
7. Mbështetje nismave kulturore dhe artistike që krijojnë vlerë të shtuar për kontekstin social dhe zhvillimin e sinergjive brenda shoqërisë civile.

Statistikisht shpërndarja e projeteve nën secilin prioritet strategjik paraqitet sipas tabelës nr. 1 të mëposhtme:


Tabela (1): Shëprndarja e Projekteve Thirrja Nr. 9, sipas Prioriteteve Strategjike

NR	Fushat Prioritare	Nr Projekteve	Shuma e financuar per secilin prioritet	Pesha Spcifike ne %
1	Mbështetje e nismave që ndikojnë në përmirësimin e kushteve të grupeve në nevojë dhe personave me aftësi të kufizuar, përfshirë këtu mbështetjen me infrastrukturë ndihmëse, fuqizimin e kapaciteteve profesionale dhe nxitjen e zhvillimit të shërbimeve nga operatorët, sensibilizimin e shoqërisë dhe rritjen e ndjeshmërisë ndaj tyre;	6	15,200,000	17.8
2	Evidentimi i nismave të qeverisjes së mirë përfshi këtu ndikimin e shoqërisë civile dhe pjesëmarrje në zhvillimin e politikave dhe përmirësimet në sistemet e ofrimit të shërbimeve me në qendër qytetarin, luftën ndaj korrupsionit përmes inovacionit dhe modernizimit të sistemeve pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të qyterarëve dhe shoqërisë civile në performancën e shërbimeve dhe politikë-bërje;	5	10,000,000	11.7
3	Mbështetja e nismave dhe reformave që përmirësojnë mjedisin mundësues të shoqërisë civile, fuqizimi e rolit të organizatave të shoqërisë civile në to dhe zhvillimin e politikave prioritare dhe sektoriale, krijimi i kushteve për sisteme që rrisin dhe lehtësojnë një mjedis mundësues, përfshirë rritjen e rolit të shoqërisë civile në komunikimin publik dhe dialogun për zhvillim;	1	2,500,000	2.9
4	Fuqizimi i barazisë gjinore, luftës kundër diskriminimeve që rrjedhin nga seksi, raca apo bindje të tjera personale;	5	15,000,000	17.6
5	Fuqizimi i nismave që kanë si objektiv mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e ndërgjegjshmërisë ambientaliste të qytetarëve, kryesisht të rinjve;	7	12,400,000	14.6
6	Fuqizimi i iniciativave rinore, si edhe lidhjeve me partnerë rajonalë dhe ndërkombëtarë në këtë sektor dhe zhvillimin lokal dhe rajonal të vendit; krijimi i kushteve për biznese sociale dhe aktivitete të tjera me karakter inovativ.	1	1,000,000	1.17
7	Mbështetje nismave kulturore dhe artistike që krijojnë vlerë të shtuar për kontekstin social dhe zhvillimin e sinergjive brenda shoqërisë civile.	2	3,500,000	4.1
8	Më shumë se një fushë	14	25,600,000	30.05

Siç mund të vërehet nga tabela prioriteti me përqindjen me të lartë të projekteve të zbatuara është ai nën kategorinë më shumë se një fushë prioritare me **30.05%** që do të thotë se në këtë prioritet projektet implementuese kanë qenë të një natyre me të gjerë; pasuar më tej prioritetin është ai “Mbështetje e nismave që ndikojnë në përmirësimin e kushteve të grupeve në nevojë dhe personave me aftësi të kufizuara, përfshirë këtu mbështetjen me infrastrukturë ndihmëse, fuqizimin e kapaciteteve profesionale dhe nxitjen e zhvillimit të shërbimeve nga operatorët, sensibilizimin e shoqërisë dhe rritjen e ndjeshmërisë ndaj tyre” me **17.8%** dhe “Fuqizimi i barazisë gjinore, luftës kundër diskriminimeve që rrjedhin nga seksi, raca apo bindje të tjera personale” me **17.6%**.

Përqindjen më të ulët të mbullimit me projektet e zë prioriteti “Mbështetja e nismave dhe reformave që përmirësojnë mjedisin mundësues të shoqërisë civile, fuqizimi e rolit të organizatave të shoqërisë civile në to dhe zhvillimin e politikave prioritare dhe sektoriale, krijimi i kushteve për sisteme që rrisin dhe lehtësojnë një mjedis mundësues, përfshirë rritjen e rolit të shoqërisë civile në komunikimin publik dhe dialogun për zhvillim” me **2.9%**.

Grafikisht të dhënat e tabelës së më sipërme shprehen si më poshtë:



Shpërndarja territoriale sipas qarqeve administrative e projekteve fituese Thirrja Nr. 9


Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në mënyrë të vazhueshme duke qenë se në filozofinë e saj e misionin e saj ka një shpërndarje të projekteve fituese sa më të gjerë në të gjithë territorin. Në të njëjtën përjasje edhe në thirrjen e saj Nr. 9 të drejtuar OJF-ve për shprehje interesi për Projekt Propozime e ka pasur si objektiv kryesor një shpërndarje territoriale sa më të gjerë në nivel kombëtar.

Në Tabelën nr. 1 shihet pikërisht shpërndarja tërëtoriale sipas Qarqeve Administrative e Projekteve fituese të Thirrjes 9, ndërkohë që në Tabelën nr. 2 është pasqyruar shpërndarja territoriale sipas qyteve brenda qarkut administrativ.

Tab. 1. Ndarja territoriale e projekteve per Thirrjen 9 sipas Qarqeve Administrative

Nr.	Shtrirja në Nivel Qarku	Nr. i projekteve Thirrja Nr. 9
1	Qarku i Beratit	3
2	Qarku Dibër	1
3	Qarku Durrës	2
4	Qarku Elbasan	3
5	Qarku Fier	3
6	Qarku Gjirokastrë	3
7	Qarku i Korçë	3
8	Qarku Kukës	2
9	Qarku Lezhë	2
10	Qarku Shkodër	3
11	Qarku Tiranë	8
12	Qarku Vlorë	3
13	Projekte në Nivel Kombëtar	5

Nga ana grafike të dhënat e tabelës së mësipërme lidhur me shpërndarjen territoriale sipas qarqeve administrative do të pasqyroheshin sipas grafikut.nr. 1




Tab. 2 Shpërndarja Territoriale e projekteve për Thirrjen 9 sipas qyteteve:

Nr.	Shtrirja në Nivel Qarku	Nr. i projekteve Thirrja Nr. 9
1	Qarku i Beratit	3
1.1	Berat	3
1.2	Kucovë	0
1.3	Skrapar	0
2	Qarku Dibër	1
2.1	Peshkopi	1
2.2	Bulqizë	0
2.3	Mat	0
2.4	Klos	0
3	Qarku Durrës	2
3.1	Durrës	2
3.2	Krujë	0
4	Qarku Elbasan	3
4.1	Elbasan	0
4.2	Gramsh	2
4.3	Librazhd	0
4.4	Peqin	1
5	Qarku Fier	3
5.1	Fier	2
5.2	Lushnje	0
5.3	Mallakastër	0
5.4	Roskovec	1
6	Qarku Gjirokastrë	3
6.1	Gjirokastrë	1
6.2	Përmet	1
6.3	Tepelene	1
7	Qarku i Korçë	3
7.1	Korçë	0
7.2	Devoll	1
7.3	Pogradec	1
7.4	Kolonje	0
7.5	Maliq	0
7.6	Pustec	1

8	Qarku Kukës	2
8.1	Kukës	1
8.2	Tropojë	1
8.3	Has	0
9	Qarku Lezhë	2
9.1	Lezhë	2
9.2	Kurbin	0
9.3	Mirditë	0
10	Qarku Shkodër	3
10.1	Shkodër	2
10.2	Puke	0
10.3	Malësi e Madhe	1
10.4	Vau i Dejës	0
10.5	Fush-Arrëz	0
11	Qarku Tiranë	8
11.1	Tiranë	3
11.2	Kamëz	2
11.2	Kavajë	2
11.4	Vore	1
12	Qarku Vlorë	3
12.1	Vlore	0
12.2	Sarandë	1
12.2	Delvine	1
12.4	Selenice	0
12.5	Himarë	1
12.6	Finiq	0
12.7	Konispol	0
13	Projekte në Nivel Kombëtar	5

Grafik nr. 2. Të dhënat e tabelës së mësipërme pasqyrohen sipas grafikut të mëposhtëm:



Siç mund të vihet re nga të dhënat e mësipërme të tabelës; si dhe nga grafiku; Projektet fituese kanë një përqëndrim më të lartë të zbatueshmërisë në rrethin e Tiranës.

Mbulimi për financim me projekte në përgjithësi prek të gjitha qarqet administrative. Mbulimin më të lartë siç u përmend dhe më të lartë e zë Qarku i Tiranës, më pas vijne qarqet Berat; Vlorë; Gjirokastrë Elbasan, Durrës, Korçë etj;

KAPITULLI III

Në mbështetje të nenit 104 pika 4 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 65 të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (te ndryshuar) si dhe në kuadër të Udhezimit nr.22 datë 17/11/2016 “Per procedurat standarte te Monitorimit te Buxhetit ne Njesitë e Qeverisjes Qendrore”, ju paraqesim Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për Agjencine për Mbështetje të Shoqërisë Civile për Vitin 2016.

1. Monitorim vlerësimi i treguesve buxhetorë për vitin 2016

Siç edhe dihet, Monitorimi në këtë rast është një proces vlerësimi performance i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara. Pra, monitorimi është procesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre.

Me anë të këtij relacioni/raporti monitorimi të Buxhetit të AMSHC - së për Vitin 2016 të detajuar, ju detajojmë informacionin mbi efektivitetin e përdorimit të fondeve buxhetore dhe performancën e produkteve të realizuara për Vitin 2016 për sa i përket Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

Në përdorimin e fondeve buxhetore, AMSHC–ja është mbështetur në parimet e menaxhimit dhe mirëfunksionimit të sistemit buxhetor. Shpërndarja e burimeve financiare është bërë në përputhje me politikat ekonomike dhe prioritetet e AMSHC –së, duke pasur si synim një përdorim sa më eficient të këtyre burimeve, përgjegjësi të qarta për menaxhimin e shpenzimeve për çdo produkt, në funksion të realizimit të objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara për vitin 2016.

2. Plani fillestar i Buxhetit Viti 2016

Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në mbështetje të Ligjit Nr.147/2015 “Për Buxhetin e Vitit 2016”, dekretuar me dekretin e Presidentit Nr.9376, datë 24.12.2015, Udhëzimit të përhershëm të Ministrit të Financave Nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” si dhe në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr.1, dt.15.01.2016 “Për zbatimin e Buxhetit të Vitit 2016”, i është akorduar një fond i planifikuar prej **122 milione e 500 mijë lekë**, i detajuar si më poshtë (Tab.Nr.1) nga:

Tabela Nr.1

Fondi i Pagave:	13,000,000 Lekë (zeri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqërore:	2,500,000 leke (zeri 601)
Fondi per Shpenzime Operative:	5,000,000 Lekë (zeri 602)
Fondi per transfertat ndaj te treteve:	101,000,000 Lekë (zeri 604)
Fondi per Investimet e Trupezuara:	1,000,000 Lekë (zeri 231)
TOTAL	122,500,000 LEKE

3. Rishikimi i Buxhetit per Vitin 2016 nepermejt Akteve Normative

Përgjatë Vitit financiar 2016, ka pasur ndryshime në Planin Vjetor 2016 per Buxhetin plan të AMSHC–së mbështetur në Aktin Normativ Nr.2, datë 16.12.2016 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr.147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, në zbatim të Urdhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” të ndryshuar si dhe bazuar në Udhëzimin plotësues nr.1 datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të Vitit 2016”, pakësimet për Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile sipas planit të rishikuar të buxhetit për vitin 2016 sipas tabelës poshtë shënuar:

1. *Mbështetur në Aktin Normativ Nr.1 dt.29.07.2016 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr.147/2015 “Për Buxhetin e Vitit 2016” “ AMSHC –së ju akordua një shtim në llogarinë 604 prej 5,000.000 leke pra totali i 604 për muajin shtator si plan thesari ka qënë 106,000,000 lekë. Më pas me kërkesën e Institucionit dhe miratimin e Ministrisë së Financave fondi prej 5,000,000 lekësh kaloi në llogarinë e shpenzimeve operative.*

2. Mbështetur në Aktin Normativ Nr.2, datë 16.12.2016 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr.147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, si dhe në zbatim të Urdhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” te ndryshuar si dhe Udhëzimit plotësues nr.1 datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të Vitit 2016”, ndryshimet në planin e Buxhetit për AMSHC ne janë sipas tabelës poshteshënuar:

Tabela e pakësimeve në zbatim të Aktit Normativ Nr. 2, datë 16.12.2016

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile

Entiteti i Qeverisjes	Ministria e Linjes	Kod Institucionit	Emri i Institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi Degese Thesarit	Kod Projektit	Emertimi i Projektit	Debit
			Pakesohet							
01	88	1088001	Agjencia per Mbeshetjen e Shoqerise Civile		1	1110	600	3535		1,100,000
			Pakesohet							
01	88	1088001	Agjencia per Mbeshetjen e Shoqerise Civile		1	1110	601	3535		250,000
			Pakesohet							
01	88	1088001	Agjencia per Mbeshetjen e Shoqerise Civile		1	1110	602	3535		500,000
TOTAL										1,850,000

Në këtë kuadër, në mënyrë të përmbledhur saktësojmë se ndryshimet në planin fillestar të Buxhetit të AMSHC–së janë :

- Shtim ne llogarinë ekonomike 604 me 5,000,000 leke por u rialokua me kërkesën e AMSHC -së dhe aprovimin e Ministrisë së Financave në llogarine ekonomike 602
- Pakësim në llogarinë ekonomike 600 me 1,100,000 lekë
- Pakësim në llogarinë ekonomike 601 me 250,000 lekë
- Pakësim në llogarinë ekonomike 602 me 500,000 lekë

Fondet Buxhetore të planifikuara dhe të rishikuara nëpërmjet Akteve Normative për vitin 2016, për Agjencinë për Mbështetje të Shoqërisë Civile, janë **125,680,000 leke** që menaxhohen në një program me titull: “**Mbështetje për Shoqërinë Civile**”, të cilat sipas strukturës buxhetore paraqiten si më poshtë vijon.

Programi “Mbështetje për Shoqërinë Civile”

Tabela Nr.2 ne leke

Ecuria e realizimit buxhetor per Vitin 2016			
Struktura Buxhetore	Shpenzimet Progressive Fakt	Plani Vjetor sipas ndryshimeve te bera gjate vitit	Realizimi ne Perqindje
600 - Llogaria e pagave	11,282,503	11,900,000	94.8 %
601 - Kontribute sig shoq shend	1,835,815	2,250,000	81.5 %
602 - Shpenzime te tjera Korrente	4,350,455	9,500,000	45.7 %
604/1 - Tranferta GRANTE	100,086,800	101,000,000	99 %
231 - Investimet te brendshme	993,000	1,000,000	99.3 %
606 -	30,000	30,000	100 %
Totali	118,578,573	125,680,000	

4. Analiza e realizimit te treguesve buxhetore per Vitin 2016

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqerore (zeri 600-601), është realizuar në zbatim të Strukturës Organizative të miratuar me Vendim nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Statutit të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”. Ndryshuar me Vendimin nr. 789 datë 16.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, Mbështetur në Ligjin Nr.147/2015 “ Për Buxhetin e Vitit 2016”, dekretuar me dekretin e Presidentit Nr.9376, datë 24.12.2015, bazuar në VKM nr.23, dt.20.01.2016 “Për përcaktimin e numrit të Punonjësve me kontratë të Përkohshme për vitin 2016 në njësitë e qeverisjes qendrore”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr.1, dt.15.01.2016 “Për zbatimin e Buxhetit të Vitit 2016”.

Gjatë vitit 2016, numri mesatar i punonjësve për AMSHC-në është realizuar 14 punonjës të përhershëm si dhe dy punonjës me kontratë të përkohshme.

Nga fondi i përgjithshëm i pagave dhe shpërblimeve, si dhe i sigurimeve shoqërore, gjatë këtij viti, është realizuar respektivisht:

- **11,282,503 Lekë** (zeri 600) për paga, realizimi **94.8 %**.
- **1,835,815 Lekë** (zeri 601) për kontribute për sigurimet shoqërore shëndetsore, realizimi **81.5 %**.
- Shpenzimet e Personelit janë realizuar në vlerën **94.8 %** për arsye të mosplotësimit të vendeve vakante në strukturat e institucionit, për shkak të hyrjes në fuqi të Ligjit të ri të statusit të nëpunësit civil dhe procedurave që duhet të ndiqen për punësimin e nëpunësve civil nëpër Institucione që mesa duket marrin kohë.

Fondi për shpenzime të tjera korrente (zeri 602), për vitin 2016, është planifikuar fillimisht me Ligjin e Buxhetit të Vitit 2016 në vlerën **5,000,000 leke**.

Me rishikimin e Buxhetit mbështetur në Aktin Normativ nr.1, datë 29.07.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, si dhe në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Financave nr.2, datë 27.01.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, AMSHC- se ju shtua 5,000,000 leke në llogarinë e Granteve 604 por me kërkesën e Institucionit për rishpërndarje fondesh kjo vlere u rialokua në llogarinë e shpenzimeve operative duke bërë që totali i 602 pas rishikimit të buxhetit nëpërmjet dy Akteve Normative të Ligjit të Buxhetit të Vitit 2016, të jetë 9,500,000 leke në total llogaria e shpenzimeve operative 602.

Edhe për këtë zë, për gjatë vitit 2016 është realizuar vlera prej **4,350,455 Lekë** ose **45.7%** e planit vjetor të rishikuar për AMSHC–në.

Detajimi i shpenzimeve korrente për Vitin 2016

Detajimi I shpenzimeve korrente për Vitin 2016			
Nr.llogarise	Emertimi	Shumat ne Leke	Shumat ne perqindje
6020100	Kancelari	22680	0.52%
6020200	Materiale per pastrim	21960	0.50%
6020300	Materiale per funksionimin e zyrave	87000	2.00%
6022010	Elektricitet	262465	6.03%
6022008	Ruajtje Objekti	467958	0.1075653%
6022009	Sherbim pastrimi	144000	3.31%
6022031	Telekomi	0	
6022033	Telefonia celulare	0	
6022034	Internet	0	
6022040	Posta	7584	0.17%
6022099	Njoftime ne gazete	119000	2.74%
6023100	Karburant dhe vaj	451080	10.37%
6023200	Udhetim I jashtem	1807655	41.55%

6024300	Shpenzime mirembajtje godine	0	
6025800	Shpenzime mirembajtje pajisje zyre	9799	0.23%
6026100	Shpenzime per qera salle	45660	1.05%
6029001	Shpenzime per pritje -percjellje	177050	0.0406969%
6029005	Shpenzime per Honorare	0	
6024100	udhetime te brendshme	510500	11.73%
6021010	Shpenzime per prodhim dok specifik	0	
6021099	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	70093	1.61%
6022010	Sherbime te printimit dhe publikimit	0	
6029008	Shpenzime per tatime dhe taksa te paguara nga institucioni	68691	1.58%
6022002	shpenzime per UKT	17280	0.40%
6022007	Sherbime bankare	60000	1.38%
	TOTALE	4350455	100.00%

Në realizimin e shpenzimeve operative, AMSHC –ja është mbështetur në parimin e një shpërndarje sa më racionale të kërkesave për ecurinë optimale të veprimtarisë së Institucionit si dhe ka zbatuar “Rregjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike” për blerje dhe shërbime të cilat kryesisht lidhen me:

- Realizimin e shpenzimeve, të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa e tatime, energji elektrike, ujë, shërbime postare e telefonike, në funksion të një veprimtarie normale institucionale.
- Kyerjen e të gjitha blerjeve për nevoja të AMSHC-së, publikime, blerje kancelarike, riparime automjeti, etj.
- Kryerjen e pagesave për likuidimin e detyrimeve furnitorë dhe të tretë etj.

Mosrealizimi i plotë i fondit për Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes argumentohet me arsyet si me poshtë vijon:

- Ky mosrealizim argumentohet së pari me diferencën e mbetur të fondeve limite të procedurave të prokurimit të zhvilluara nga AMSHC-ja dhe vlerave të kontratave të lidhura me operatorët fitues, që do të thotë se fondi limit i prokuruar është më i madh se vlera e kontratës së shpallur fituese për të njëjtën procedurë.
- Gjithashtu, një pjesë e mosrealizimit të këtij zëri ka të bëjë me rishikimin e buxhetit për AMSHC në nëpërmjet Akteve Normative për rishikimin e Ligjit të Buxhetit për Vitin 2016, duke shtuar në llogarinë e AMSHC së vlerën prej 5,000,000 me kërkesë të Institucionit, por koha mbeti e pa mjaftueshme për realizimin e procedurës së prokurimit (Kërkesë për Propozim) si dhe realizimit të mundshëm të kontratës. Për këtë arsye, zëri i shpenzimeve operative 602 mbetet dhe zëri më pak i realizuar në përqindje për këtë vit fiskal.

Fondi në zërin për Transferime Korrente të Brendshme (zëri 604), për vitin 2016 është planifikuar në vlerën **101,000,000 leke**. Ky është dhe zëri më me peshë në strukturën e

buxhetit të AMSHC- së, duke qene se dhe vete Misioni i këtij Institucioni ka si qëllim kryesor financimin e Shoqërisë Civile me Grante për projektpropozimet e OJF përfituese.

Edhe për këtë zë, aktualisht **604 Kapitulli 1** për periudhen respektive është realizuar vlera prej **100,086,800 Lekë** ose **99% e planit vjetor**.

Ndërkohë disbursimet e zërit të Granteve kanë përfshirë disbursime nga Thirrja Nr.7, Thirrja Nr.8 dhe në gjysmën e dytë të Vitit fiskal 2016 janë disbursuar Projektet fituese të Thirrjes Nr.9 organizuar nga AMSHC-ja.

Një nga Risitë në disbursimet e Thirrjeve të fundit të shpalluara nga AMSHC-ja në gjysmën e dytë të Vitit 2016 është dhe mënyra e Financimit (70% Pjesa e pare e disbursimit dhe 30% Pjesa Finale e Raportim/Disbursimit) e tillë që i përshtatet si projekteve fituese ashtu edhe afateve kohore në të cilat Thirrjet u bënë publike.


5. Ecuria e disbursimeve te granteve financiare

Në Tabelën më poshtë, evidentohet *ecuria e disbursimeve te granteve financiare* (Llogaria 604 –Disbursimi i Granteve) sipas muajve gjatë vitit 2016, si dhe në grafikun më poshtë qartësohet kjo ecuri disbursimi në formë grafiku.

Ecuria e disbursimeve të granteve në mënyrë grafike për çdo muaj

Tab. në lekë

Viti 2016	
Janar	2,637,000
Shkurt	2,020,000
Mars	7,850,000
Prill	710,000
Maj	37,556,800
Qershor	22,330,000
Korrik	8,370,000
Gusht	300000
Shtator	0
Tetor	1,770,000
Nëntor	4,180,000
Dhjetor	12,363,000
TOTAL	100,086,800



Fondi per shpenzim investime (zeri 231), 1,000,000 Lekë (zeri 231) për Investime të Trupëzuara.

Gjatë tre mujorit të katërt të vitit 2016, janë finalizuar edhe praktikat e prokurimit dhe ndjekjes përsa i përket fondit të investimeve. Konkretisht është disbursuar edhe fondi i investimit për projektin e riskonstruksionit me vlerë **480,000 lekë** me TVSH gjatë muajit Shtator 2016 si dhe ka përfunduar edhe praktika e prokurimit për projektin e dytë të Investimit atë të përmirësimit të Infraskturës së IT së në Institucion me vlerë prej **190,800 lekesh**.

Ndërkohë me kërkesën e Institucionit dhe miratimin e Ministrisë së Financave, është rialokuar fondi i investimeve pjesa e mbetur pas ndjekjes së procedurave të prokurimit për çeljen e një projekti të ri investimi të tillë si "Investim në fonine e zyrës së mbledhjeve për AMSHC-në" në vlerën e celjes së projektit 329,200 dhe realizimi faktik në vlerën **322,200 leke**.

Pra realizimi i fondit të Investimeve për AMSHC në është total 993,000 leke nga 1,000,000 plan buxheti me një përqindje prej 99.3 % .

AMSHC është një Institucion qendror buxhetor i krijuar me Ligjin Nr. 10093 Date 09.03.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile" dhe VKM Nr. 769 Date 15.07.2009 "Për Miratimin e Statutit të AMSHC-se" (I ndryshuar), me Mision themelor "*Nxitjen e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Shoqërisë Civile*", si dhe "*Krijimin e kushteve të favorshme për nisma civile*", në të mirë dhe në interes të publikut.

Për realizimin e Misionit, AMSHC-ja ofron "*asistencë financiare*" për programet, që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse, bashkëpunimin ndërsektorial e ndërkombëtar, nismat civile, filantropinë, vullnetarizmin e institucionet demokratike të shoqërisë, si dhe programe të tjera si trajnime/ëorkshops/konferenca/takime rajonale që lehtësojnë përmbushjen e misionit të saj.

Duke filluar nga *muaji Nëntor 2010 e deri në fund të vitit 2016* Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile udhëhequr nga Bordi Mbikqyrës I AMSHC- së, ka organizuar **9 Thirrje për Projekt-Propozime** sipas prioriteteve dhe fushave të cilat janë objektiva të përhershëm të Institucionit, dhe janë kryer procedurat e duhura konform Ligjeve në fuqi në lidhje me njoftimin, shpalljen, vlerësimin, seleksionimin dhe kontraktimin e Organizatave Jofitimprurëse për financimin me Grante të projekteve që kanë rezultuar fituese. Më tej puna konkrete e AMSHC-së si Institucion, mbetet ndjekja e Projekteve deri në fazën finale të realizimit të tyre, Monitorimi dhe Vlerësimi I ecurisë së realizimit të Aktiviteteve konform projektpropozimit dhe kontratës së lidhur mes palëve si dhe Monitorimi dhe Vlerësimi I ecurisë së realizimit financiar të Projekteve të financuara nga AMSHC- ja dhe përputhshmëria me buxhetin e parashikuar si dhe me legjislacioni fiskal dhe tatimor të Republikës së Shqipërisë.

Sasia e granteve dhe Organizatave Jofitimpruese (shkurt OJF) të kontraktuara për t'u Financuar për secilën Thirrje të organizuar nga AMSHC paraqitet si vijon:

Tabela 4 (ne Leke):

Thirrja	Numri i OJF-ve Perfituese	Vlere e Granteve financiare (ne Leke)
Thirrje Nr. 1	52	125,918,000
Thirrje Nr. 2	31	16,000,000
Thirrje Nr. 3	69	131,960,000
Thirrje Nr. 4	63	62,105,000
Thirrje Nr. 5	47	55,200,000
Thirrje Nr. 6	21	43,755,840
Thirrje Nr. 7	41	73,500,000
Thirrje Nr. 8	18	36,000,000
Thirrje Nr. 9	41	85,200,000
TOTAL	383	629,638,840

Puna kryesore e AMSHC- së për Vitin 2016 është përqendruar në realizimin me sukses të Thirrjeve për Projekt-Propozime si dhe ndjekjes/Monitorimit/Vlerësimin të projekteve të zbatuara në kuadër të këtyre Thirrjeve.

KAPITULLI IV

Aktivitetet kryesore të AMSHC-së për vitin 2016

Sesion informues mbi mirëqeverisjen dhe luftën kundër korrupsionit
Tiranë, 29 janar 2016



Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së, z. Andi Kananaj mori pjesë në Sesionin Informues me temë: "Forcimi i kapaciteteve dhe ndikimi i Organizatave të Shoqërisë Civile në mirëqeverisje dhe luftën kundër korrupsionit në nivelet e qeverisjes vendore", i cili u zhvillua në ambientet e Hotel Tirana International.

Ky takim u organizua nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Qendra Kombëtare Shqiptare për Trajnim dhe Asistencë Teknike (ANTTARC).

Në kuadër të programit IPA 2014/2015, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri ka përzgjedhur për të financuar dy projekte:

- Projekti: CIVILISC – Instrumentet e Shoqërisë Civile në luftën kundër korrupsionit do të implementohet nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në bashkëpunim me Fondacionin bullgar "Risk Monitor" në 20 bashki të vogla e të mesme të vendit.
- Projekti: PACT – Partneritet në luftën kundër korrupsionit do të implementohet nga një konsorcium organizatash drejtuar nga Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike, në partneritet me Fondacioni Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale (ALCDF) dhe Qendra Vepra për Shoqërinë në 15 bashki të zonës veriore të vendit.

Në prezantimin e dy projekteve CIVILISC dhe PACT morën pjesë organizatat e shoqërisë civile, institucionet shtetërore, donatorët dhe aktorë të tjerë përfitues si media dhe institucionet akademike.

**Takimi përmbyllës i konsultimeve mbi procedurat e nominimit, votimit online dhe përzgjedhjes së anëtarëve të shoqërisë civile, pranë KKSHC-së
Tiranë, 4 shkurt 2016**



Në ambjentet e Ministrisë të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) u zhvillua takimi përmbyllës i konsultimeve në lidhje me procedurën për zgjedhjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile si anëtarë të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC). Ky takim u organizua nga MMSR-ja në bashkëpunim me Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC).

Në këtë takim morën pjesë Ministri i MMSR-së, z. Blendi Klosi, Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së, z. Andi Kananaj, përfaqësuesi i Zyrës së Delegacionit të Bashkimit Evropian, z. Stefano Calabretta, anëtarja e Bordit Mbikëqyrës të AMSHC-së znj. Kozara Kati si dhe një numër i konsiderueshëm përfaqësuesish nga Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC).

Të pranishmit i përshëndeti me fjalën e tij Ministri Klosi, në cilësinë e Kryetarit të KKSHC-së, i cili vuri theksin te rëndësia që ka ngritja e këtij Këshilli, si urë bashkëpunimi midis

qeverisë dhe sektorit të shoqërisë civile, për zbatimin e Strategjisë Kombëtare në krijimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e këtij sektori.

Më pas, fjalën e mori z. Calabretta, i cili përgëzoi dhe inkurajoi përpjekjet dhe arritjet e deri tanishme në këtë fushë.

Në vijim Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së, z. Kananaj shpjegoi për të pranishmit procedurat nëpër të cilat do të kalojë ky proces dhe më pas, znj. Kati inkurajoi përfaqësuesit e OSHC-ve për një pjesëmarrje sa më aktive dhe cilësore në këtë proces.

Gjithashtu, në kuadër të këtij procesi u prezantua kalendari i planit të veprimit, i cili parashikon që nga data 5 deri në 12 shkurt të jetë periudhë për paraqitjen dhe nominimin e kandidatëve për anëtarë të KKSHC-së. Po ashtu, që nga data 5 shkurt, kalendari parashikon edhe ngritjen e një komisioni ad-hoc zgjedhor edhe me një përfaqësues ndërkombëtar.

Ndërkohë që nga data 13 shkurt do bëhet publikimi i kandidaturave të kualifikuara gjatë nominimeve dhe vendoset një afat 3-ditor për kontestim të të nominuarve të skualifikuar. Në datën 16 shkurt do të shpallet votimi online për një periudhë 8-ditore dhe në datën 25 shkurt do bëhet shpallja e fituesve.

Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile do të ketë 27 anëtarë, 13 nga të cilët do të jenë përfaqësues të nivelit të lartë drejtues të institucioneve publike, 13 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe 1 përfaqësues nga komuniteti i biznesit.

Në këtë takim disa prej çështjeve që u trajtuan dhe u sugjeruan nga të pranishmit ishin: përzgjedhja e kandidatëve të bëhet me kritere të sakta e të qarta; të mbahet parasysh barazia gjinore mes kandidatëve; përfaqësimi i të gjitha shtresave të shoqërisë me tërë problematikat e tyre, etj.



Konferenca kombëtare "Siguria e Fëmijëve në Internet"
Tiranë, 9 shkurt 2016



Në kuadër të ditës ndërkombëtare të "Internetit të Sigurt", përfaqësuesi i AMSHC-së, z. Kastriot Tota, mori pjesë në konferencën kombëtare "Siguria e Fëmijëve në Internet", e cila u zhvillua në 9 shkurt 2016, ora 10:00-11:30 pranë Hotel Tirana International. Kjo konferencë u organizua nga Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike; Ministria e Arsimit dhe Sportit; Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me UNICEF dhe në

partneritet me Qendrën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve - CRCA Shqipëri. Në këtë takim u nënshkrua "Marrëveshja e Bashkëpunimit për Sigurinë e Fëmijëve në Internet", e cila synon rritjen e efikasitetit të ndërveprimit institucional në funksion të sigurisë online për fëmijët ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme dhe mbrojtjen e tyre nga dhuna, shfrytëzimi, abuzimi, rreziqet dhe kërcënimet që vijnë gjatë lundrimit në internet.

Workshop Rajonal - "Aksesi i fëmijëve rom në shërbimet e fëmijërisë së hershme"
Tiranë, 11 shkurt 2016

Workshopi rajonal i organizuar nga Bashkia Tiranë, Këshilli i Qarkut, CRCA Shqipëri, Observatori për të Drejtat e Fëmijës dhe UNICEF, në kuadër të vitit të dytë të programit "Çdo Fëmijë Rom në Kopsht", u zhvillua në ambientet e Qendrës Rinore të Tiranës.

Në këtë workshop mori pjesë edhe përfaqësuesi i AMSHC-së, z. Kastriot Tota; Zv. Kryetarja e Bashkisë Tiranë, znj. Brunilda Paskali; Zv. Kryetare e Këshillit të Qarkut Tiranë, znj. Bora Panajoti; përfaqësues të UNICEF Shqipëri si dhe përfaqësues të CRCA Shqipëri, gjithashtu dhe nga Observatori i të Drejtave të Fëmijëve. Në takim kishte shumë të pranishëm nga oragizatrat dhe komuniteti rom.



Ky workshop zhvillohet në kuadër të programit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe UNICEF me mbështetjen e Zyrës së Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri dhe Kooperimit Austriak për Zhvillim. Workshopi synonte të mblidhte së bashku aktorët kryesorë të qarkut të Tiranës për të diskutuar mbi vështirësitë dhe sfidat e hasura vitin e dytë të iniciativës "Çdo Fëmijë Rom në Kopsht" si dhe të hidhte dritë mbi rezultatet e arritura duke dhënë disa modele pozitive integrimi, që kanë ndikuar në uljen e përjashtimit social të fëmijëve rom si dhe rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor nga ky komunitet.

Ditë Informimi rreth modaliteteve të Thirrjes së Parë për Projekte, në kuadër të Programit BalkanMed 2014-2020
Tiranë, 18 shkurt 2016



Një përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) mori pjesë në Ditën e Informimit rreth modaliteteve të Thirrjes së Parë për Projekte, në kuadër të Programit BalkanMed 2014-2020, organizuar nga Ministria e Integritimit Evropian në bashkëpunim me Autoritetin Menaxhues të Programit BalkanMed. Ky aktivitet u organizua në ambientet e Hotel Tirana International. Në këtë event informues morën pjesë një numër i konsiderueshëm përfaqësuesish të Organizatave të Shoqërisë Civile si dhe të institucioneve publike.

Prezantimi i Programit BalkanMed 2014-2020, më konkretisht, prioritetet, objektivat dhe modalitetet e implementimit të tij u bënë nga përfaqësues të Ministrisë së Integritimit Evropian dhe dy përfaqësues të Autoritetit Menaxhues të Programit BalkanMed. Përfaqësuesit e Autoritetit Menaxhues të Programit BalkanMed, znj. Nikoletta Tatari dhe z. Themistoklis Chatzikonstantinou prezantuan para pjesëmarrësve, në mënyrë të detajuar, të gjitha etapat nëpër të cilat do të kalojë ky proces. Temat rreth të cilave u diskutua ishin kryesisht plotësimi i Formularit të Aplikimit, specifikimi i buxhetit, dokumentacioni i nevojshëm shoqëruar, ngritja e partneriteteve, ligjshmëria në lidhje me aplikimin, kriteret e përzgjedhjes dhe vlerësimi, komunikimi dhe finalizimi i projektit etj.

Pas prezantimit, pjesëmarrësit adresuan një sërë pyetjesh dhe kërkuan sqarime të mëtejshme rreth mënyrës së aplikimit dhe vështirësive që ata hasin gjatë këtij procesi. Paneli drejtues i kësaj Dite Informimi bëri shpjegimet e duhura duke iu përgjigjur të gjitha pyetjeve të bëra në adresë të tyre. Në mbyllje të takimit pjesëmarrësit diskutuan edhe për takimin e radhës, i cili do të jetë në kuadër të diskutimit të Programit ADRION 2014-2020, më 29 shkurt 2016.

Workshop - "Hartimi i Politikave dhe Programimi Financiar i Modelit të ri të Menaxhimit Rajonal në Shqipëri"
Tiranë, 25 shkurt 2016



Në kuadër të një diskutimi të hapur për adresimin e instrumenteve institucionale dhe financiare për zhvillimin rajonal në Shqipëri, Instituti i Politikave Publike dhe Private (IP3), Njësia e Bashkërendimit të Programeve Zhvillimore dhe Planifikimit Strategjik në Kryeministri, në bashkëpunim me Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), organizuan, në mjediset e Hotel Mondial, workshop-in me temën "Hartimi i Politikave dhe Programimi Financiar i Modelit të ri të Menaxhimit Rajonal në Shqipëri".

Në këtë workshop morën pjesë përfaqësues nga Kryeministria, Ministria e Financave, Ministria e Mjedisit, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, si dhe një numër i konsiderueshëm përfaqësuesish nga Agjenci dhe Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC-ve).

Fokusi i këtij workshopi ishte hartimi i politikave zhvillimore, programimi dhe zbatimi i instrumenteve financiar, në funksion të zhvillimit rajonal të vendit, bazuar mbi një analizë të bërë nga Instituti i Politikave Publike dhe Private (IP3) lidhur me skemën e financimit të investimeve publike në nivelin lokal dhe atë rajonal.

Pjesëmarrësve ju uroi mirëseardhjen znj. Albana Dhimitri, Drejtore Ekzekutive pranë Institutit të Politikave Publike dhe Private (IP3) dhe më pas përshëndeti znj. Eriola Muka, Drejtore e Departamentit të Zhvillimit Rajonal dhe Lokal në Kryeministri, e cila vuri theksin te rëndësia që ka adresimi i instrumenteve institucionale dhe financiare për zhvillimin rajonal të vendit.

Gjatë workshop-it fjalën e morën gjithashtu dhe tre eksperte pranë (IP3), konkretisht znj. Besmira Vishe, e cila bëri një përshkrim të shkurtër rreth krijimit të Agjencive të Zhvillimit Rajonal, znj. Monika Brahimi e cila foli rreth historikut të Fondeve të Zhvillimit Rajonal si dhe znj. Blerta Guda, që bëri prezantimin e krijimit të Instrumenteve të Qëndrueshëm Financiar për Zhvillimin Rajonal në Shqipëri.

Në mbyllje të diskutimeve të pranishmit nxorën konkluzione dhe dhanë disa rekomandime për të ardhmen si:

- *Objektivat e Fondit të Zhvillimit Rajonal duhet të jenë në sinkron me Strategjinë e Zhvillimit të Qëndrueshëm SDG-2030 të miratuar në Kombet e Bashkuara, shtator 2015.*
- *Fondi për Zhvillimin e Rajoneve duhet shndërrohet në një mekanizëm financiar që do të mbështesë politikën e re kombëtare të zhvillimit rajonal për të pasur rajone konkurruese me zhvillim të qëndrueshëm.*
- *Fondi për Zhvillimin e Rajoneve duhet të rritet dhe të bëhet pjesë e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA).*

Debat ndërkombëtar "Sipërmarrjet Sociale në Shqipëri – Mes përkufizimeve, qasjeve dhe zhvillimeve"
Tiranë, 26 shkurt 2016

Në kuadër të projektit "U-Impact - Nga Pjesëmarrja Qytetare tek Ndikimi në Politikën e BE-së", pjesë e programit të Bashkimit Evropian "Evropa për Qytetarët", Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim organizoi, tek "Tirana International Hotel", debatin ndërkombëtar "Sipërmarrjet Sociale në Shqipëri – Mes përkufizimeve, qasjeve dhe zhvillimeve".

Në këtë debat morën pjesë aktorë dhe institucione kontribuese të këtij zhvillimi nga ministrinë e linjës, institucione akademike, agjenci të zhvillimit e donatorë mbështetës të ndërmarrjeve të para sociale në vend, përfaqësues të këtyre ndërmarrjeve si dhe praktika të mira nga zhvillimi i sipërmarrjeve sociale në Estoni, Bullgari, Francë dhe Belgjikë.

Pjesë e këtij debati u bë dhe Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, e cila ka rritur në vijimësi angazhimin dhe kontributin e saj në financimin e projekteve të Organizatave të Shoqërisë Civile në këtë fushë, duke ndikuar në përshtatshmërinë e legjislacionit për të stimuluar sipërmarrjet sociale, organizimin dhe funksionimin e tyre në Shqipëri.

Fjalën e mirëseardhjes, prezantimin i projektit dhe strukturës së debatit e bëri znj. Arjola Agolli – Drejtore e Programeve, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim.





Debati u zhvillua në tre panele kryesore:

1. *Zhvillimet e fundit dhe trendi i praktikave të sipërmarrjeve sociale në Shqipëri; Iniciativat ligjore dhe efekti i pritshëm i tyre në zhvillimin e sipërmarrjeve dhe ndikimit të tyre në punësim - prezantuar nga z. Erion Manahasa, përfaqësues i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i cili theksoi se draft ligji për SS-të është në përputhje dhe në funksion të strategjisë kombëtare, se krijimi i SS-ve do të ndikojë së tepërmi në përmirësimin e jetës së shtresave të marginalizuara, do të rrisë ndërgjegjësimin e popullsisë ndaj kësaj shtrese, ofrimin e shërbimeve, rritjen e punësimit dhe mirëqenies ndaj shtresave që nuk kanë mundësi ose kanë mundësi të kufizuara. Gjithashtu, në këtë panel foli dhe Arben Shamia – Drejtor Ekzekutiv, YAPS -Youth Albania Professional Services, i cili solli eksperiencën e këtij biznesi social, kontributin që ai ka dhënë në punësimin e shtresave të marginalizuara.*



2. *Tendencat e zhvillimit të SS-ve në Evropë - prezantuar nga Jaan Aps, former CEO of the Estonian Social Enterprise Network, Petko Georgiev - ProInfo – Bulgaria, Flora Graioni - IREX Europe – Francë dhe Jos Sterckx - Knowledge Centre Social Europe – Belgjikë, të cilët prezantimet e tyre i bënë me video call si një risi e re në rrugët e komunikimit.*



3. *Prezantime nga përfaqësues të SS-ve vendase dhe konkretisht Youth Center "Borderless", Fondacioni Gjirokastra dhe Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, të cilët prezantuan arritjet dhe sfidat me të cilat ndeshen SS-të e reja në Shqipëri dhe se në çfarë mase janë ekspozuar ato ndaj rrjeteve të SS-ve rajonale e ndërkombëtare.*

Në fund të çdo diskutimi të pranishmit adresuan pyetje të ndryshme dhe shkëmbyen mendime lidhur me tematikat e debatuar.

**Takim i ekipit të Tetra Tech ARD dhe përfaqësuesve të AMSHC-së
Tiranë, 1 mars 2016**



Në kuadër të hartimit të strategjisë së ardhshme pesëvjeçare të USAID-it për Shqipërinë, u zhvillua në zyrat e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), një takim midis ekipit të Tetra Tech ARD dhe përfaqësuesve të AMSHC-së.

Ekipi ishte i përbërë nga ekspertë të Tetra Tech ARD dhe zyrtarë të USAID-it: Znj. Sue Nelson– Drejtuese e Ekipit të Vlerësimit (Konsulente e Tetra Tech ARD), Dr. Clarissa de Waal– Specialiste për Vendin (Konsulente e Tetra Tech ARD), Znj. Silvana Rusi, Analiste Lokale (Konsulente e Tetra Tech ARD), dhe Znj. Faye Hasselkorn – Zyrtare e Programit të Demokracisë dhe Qeverisjes (USAID Washington).

AMSHC-ja përfaqësohej nga Znj Leonida Hasa, Znj. Mimoza Çorbaxhi, Z. Kastriot Tota dhe Znj. Silva Gjini.

Në këtë takim u diskutua në lidhje me funksionimin dhe organizimin e AMSHC-së, duke u fokusuar veçanërisht në çështje si:

- *Misioni dhe objektivat e AMSHC-së;*
- *Fushat e veprimtarisë;*
- *Mënyrat e financimit të AMSHC-së;*
- *Bashkëpunimi Qeverisje Qendrore dhe Lokale me Shoqërinë Civile;*
- *Krijimi dhe funksionimi i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile;*
- *Arritjet dhe sfidat e deritanishme në sektorin e Shoqërisë Civile;*
- *Pritshmëritë dhe hapësirat për përmirësim në të ardhmen;*
- *Kriteret dhe procedurat në aplikimet dhe financimet me grante;*
- *Problemet e hasura gjatë implementimit të projekteve, si dhe impakti që këto projekte kanë në shoqëri;*
- *Hapësirat dhe mundësitë e bashkëpunimit në krijimin e rrjeteve të Organizatave të Shoqërisë Civile në të ardhmen.*



Takimi u karakterizua nga fryma e diskutimit të lirë dhe u trajtuan çështje reale që shqetësojnë OSHC-të në Shqipëri.

KONFERENCË KOMBËTARE - "Krijimi i një mjedisi mundësues dhe ngritja e kapaciteteve për zhvillimin e organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri"
Tiranë, 2 mars 2016



Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim organizuan një konferencë kombëtare me titull "Krijimi i një mjedisi mundësues dhe ngritja e kapaciteteve për zhvillimin e organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri", e cila u zhvillua në ambjentet e Hotel Mondial në Tiranë.

Në konferencë morën pjesë z. Andi Kananaj, Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC); znj. Plejada Gugashi, Manaxhere Lokale Programi - The Olof Palme International Center, Shqipëri; z. Stefano Calabretta – Manaxher i Programit për Shoqërinë Civile dhe të Drejtat e Njeriut, Delegacioni i Bashkimit Evropian për Shqipërinë; znj. Karolina Mikova, Drejtore, Partnerët për Ndryshim Demokratik Sllovaki si edhe përfaqësues të komunitetit donator dhe organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri dhe Sllovaki.

Gjatë konferencës u prezantuan gjetjet dhe rekomandimet nga Matrica e Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Raporti për Shqipërinë 2015. Matja e kuadrit ligjor dhe praktik mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile, bazohet në parimet dhe standartet kryesore ndërkombëtare. Në fokus të diskutimeve ishte krijimi i një mjedisi mundësues dhe bashkëpunimi i OSHC-ve me institucionet shtetërore në Shqipëri dhe vendet anëtare të BE-së.

Monitorimi i mjedisit mundësues për shoqërinë civile mbështetet nga Bashkimi Evropian, Balkan Trust for Democracy dhe Olof Palme International Center në Shqipëri përmes financimit të Qeverisë Suedeze.

Në konferencë u theksua roli i AMSHC-së dhe i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile në Shqipëri.

Në vijim u prezantua Akademia e OJF-ve, një program inovativ i Partnerëve Shqipëri për ngritjen e kapaciteteve të drejtuesve të OJF-ve shqiptare për të ndërtuar organizata efektive në shërbim të publikut dhe grupeve të interesit.

Një pjesë e aktiviteve të Akademisë së OJF-ve po zbatohen në bashkëpunim me Partnerët për Ndryshim Demokratik Sllovaki me mbështetjen financiare të

Olof Palme International Center në Shqipëri përmes financimit të Qeverisë Suedeze dhe Slovak Aid – Asistenca Zyrtare për Zhvillim e Republikës Sllovake.



AMSHC organizon takim informues në Shkodër
Shkodër, 8 mars 2016

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) organizoi një takim informues në Shkodër, në kuadër të procesit të përzgjedhjes së kandidatëve për Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) si edhe informacion mbi aplikimet për Thirrjen Nr. 9 për projekt-propozime, takim i cili u zhvillua në ambjentet e Qendrës Rinore Arka. Në këtë takim, Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së, z. Andi Kananaj si dhe z. Erion Banushi informuan më gjerë të ftuarit e shoqërisë civile mbi rëndësinë dhe procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për KKSHC-në. Gjithashtu informuan edhe mbi mënyrën dhe dokumentacionet e kërkuara për aplikim me projekt-propozime në kuadër të Thirrjes Nr. 9, e cila vazhdon të jetë e hapur deri në datën 25 mars 2016.



AMSHC organizon takim informues në Pogradec
Pogradec, 11 mars 2016

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) organizoi takimin informues të radhës në Pogradec, në kuadër të procesit e përzgjedhjes së kandidatëve për Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) si edhe informacion mbi aplikimet për Thirrjen Nr. 9 për projekt-propozime, takim i cili u zhvillua në ambientet Hotel Millennium në Tushemisht, Pogradec.



Në këtë takim morën pjesë përfaqësuesit e AMSHC-së, z. Erion Banushi, znj. Leonida Hasa dhe z. Ferhat Aga, të cilët informuan të ftuarit e shoqërisë civile mbi rëndësinë dhe procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për KKSHC-në si edhe mbi mënyrën dhe dokumentacionet e kërkuara për aplikim me projekt-propozime në kuadër të Thirrjes Nr. 9.



AMSHC organizon takimet informuese e radhës në Vlorë, Kukës dhe Korçë

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) në kuadër të procesit e përzgjedhjes së kandidatëve për Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) si edhe informacion mbi aplikimet për Thirrjen Nr. 9 për projekt-propozime, organizoi takimet informuese të radhës në Vlorë, Kukës dhe Korçë, përkatësisht në datat 11, 18 dhe 21 mars 2016.

Në këto takime morën pjesë përfaqësuesit e AMSHC-së, z. Erion Banushi, z. Ferhat Aga, të cilët i informuan të ftuarit e shoqërisë civile mbi rëndësinë dhe procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për KKSHC-në si edhe mbi mënyrën dhe dokumentacionet e kërkuara për aplikim me projekt-propozime në kuadër të Thirrjes Nr. 9, e cila vazhdon të jetë e hapur deri në datën 25 mars 2016.





AMSHC akreditohet si Organizatë Dërguese, Pritëse dhe Koordinuese për Shërbimin Vullnetar Evropian të Programit Erasmus +

Lubjana (Slloveni), 25 mars 2016

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) akreditohet si Organizatë Dërguese, Pritëse dhe Koordinuese me kod akreditimi Nr. 2016-1-SI02-KA110-013468, pjesë e programit Erasmus + të Komisionit Evropian: "Rinia në Veprim".

Ky akreditimi është i vlefshëm për 3 vjet deri më 25.03.2019.

Nis punimet Konferenca Rajonale P2P

"Shpërndarja transparente e fondeve publike - praktikat e mira të BE-së dhe modelet"

Jahorina (Bosnja dhe Hercegovina), 30 mars 2016



Ky event do të ofrojë një mundësi për aktorët kryesorë të OSHC-ve dhe qeverive nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (Mali i Zi, Maqedoni, Serbi, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë) dhe Turqi për të shqyrtuar praktikat aktuale dhe të shkëmbejnë përvojat lidhur me mekanizmat për financim publik transparent në mënyrë që të krijojnë një plan të orientuar veprimi, i cili do të kontribuojë në krijimin e një mjedisi të favorshëm për OSHC-të në rajon.

Në këtë konferencë morën pjesë, Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së, z. Andi Kananaj dhe z. Erion Banushi.



Konferenca "Sfidat dhe Mundësitë për Punësimin e Grupeve të Margjinalizuara nga Ndërmarrjet Sociale"

Tiranë, 20 prill 2016

Partnerët Shqipëri organizoi në Tiranë, konferencën "Sfidat dhe Mundësitë për Punësimin e Grupeve të Margjinalizuara nga Ndërmarrjet Sociale", në të cilën mori pjesë edhe z. Ferhat Aga, në cilësinë e përfaqësuesit të AMSHC-së.

Në konferencë u prezantuan gjetjet e studimit "Sfidat dhe Mundësitë për Punësimin e Grupeve të Margjinalizuara nga Ndërmarrjet Sociale" në Shqipëri dhe Maqedoni, duke ofruar një vështrim të përgjithshëm të ndërmarrjeve sociale, karakteristikave të zhvillimit të tyre, shtrirjes, si dhe mundësive për punësimin dhe integrimin e grupeve të marginalizuara.

Pjesë e prezantimit dhe diskutimeve në konferencë ishin edhe perspektivat dhe praktikat e ndryshme të zhvillimit të kuadrit ligjor dhe praktik në vendet e rajonit dhe më gjerë.



Konferencë Kombëtare - "Fuqizimi i Strukturave të Qeverisjes Vendore dhe Bashkëpunimit mes të Zgjedhurve Vendorë në Shqipëri – Faza II"

Tiranë, 3 maj 2016



Këshilli i Evropës organizoi në Tiranë konferencën kombëtare "Reforma në Qeverisjen Vendore dhe Administratën Publike – Mundësi të reja për Administratën Vendore".

Konferenca mbledhi së bashku ministra, donatorë, përfaqësues të qeverisjes vendore, përfaqësues të shoqërisë civile dhe ekspertë për të diskutuar rreth zhvillimeve të fundit në lidhje me reformën e administratës publike. Në këtë konferencë mori pjesë dhe një përfaqësues i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC).

Në sesionin hapës të kësaj Konference fjalën e mori z. Bledi Çuçi, Ministër i Shtetit për Çështjet Vendore, z. Christoph

Graf, Ambasador i Zvicrës në Shqipëri si dhe znj. Claudia Luciani, Drejtoreshë e Qeverisjes Demokratike, Drejtoria e Përgjithshme e Demokracisë, Këshilli i Evropës.

Ekspertët e KiE-s prezantuan vlerësimin e nevojave kombëtare institucionale dhe të trajnimit në lidhje me qeverisjen vendore, i kryer përpara zgjedhjeve lokale të qershorit 2015. Ky vlerësim, i parë i këtij lloji dhe me këtë fushë veprimi në Shqipëri, do të shërbejë si bazë për administratën vendore në Shqipëri për zbatimin e reformës së administratës vendore.

Gjatë punimeve të kësaj konference përshëndeti dhe Ministri i Shtetit për Inovacion dhe Administratën Publike, znj. Milena Harito e cila i siguroi partnerët ndërkombëtarë për angazhimin e qeverisë për çuarjen përpara të Reformës në Administratën Publike, të shoqëruar me modernizimin e shërbimeve, duke e sjellë atë më afër qytetarëve në të gjithë vendin.

Më tej konferenca vazhdoi punimet me një sërë prezantimesh, diskutimesh dhe shkëmbim eksperiencash, të cilat konvergjuan drejt nevojës për të konsoliduar dhe për të formalizuar instrumentet moderne ekzistuese dhe praktikatat e mira që kanë të bëjnë me Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në nivel lokal dhe kombëtar.

Në fund konferenca përmbylli punimet e saj duke nxjerrë një sërë konkluzionesh, të cilat do të udhëheqin punën në të ardhmen.

**Takim përmbyllës mbi Draft Strategjinë 2014-2018, në kuadër të Programit të Grandeve të Vogla për Mjedisin, si pjesë e Programit Mjedisor Global implementuar nga UNDP
Tiranë, 10 maj 2016**

Programi i Grandeve të Vogla Mjedisore (GEF SGP) në Shqipëri, si pjesë e Programit Mjedisor Global, nëpërmjet Qendrës Rajonale për Mjedisin (REC) Shqipëri, organizoi në ambientet e Hotel Tirana International, me partnerë dhe aktorë të interesuar në këtë fushë, takimin përmbyllës të konsultimeve rreth Draft Strategjisë të këtij Programi Kombëtar, për Fazën Operacionale 6 (OP6) 2014-2018.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, UNDP, AMSHC, REC Albania, përfaqësues Qendrash dhe Organizatash të Shoqërisë Civile etj.

Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi i Draft Strategjisë përfundimtare të OP6 GEF / SGP.

Pjesëmarrësit në këtë takim shprehën pikëpamjet e tyre rreth Strategjisë se prezantuar para auditorit dhe ofruan ndihmesën e tyre me mendime dhe sugjerime lidhur me fushat që ishin në fokus të kësaj Strategjie.

Gjatë takimit diskutimet u përqendruan në fushat e mëposhtme:

1. Biodiversiteti
2. Ndryshimet klimatike
3. Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm - NOQ / Kimikatet,
4. Degradimi i tokës / Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës dhe
5. Ujërat ndërkombëtare

Në takim u theksua se Programi i Grandeve të Vogla (SGP) siguron për organizatat jo qeveritare me bazë në komunitet, në vendet në zhvillim, grante të cilat ju mundësojnë atyre veprimtari ku të trajtojnë sfidat globale mjedisore duke adresuar nevojat lokale për zhvillimi të qëndrueshëm.

Programi i Grandeve të Vogla është një program në kuadër të Programit Global Mjedisor implementuar nga UNDP-ja dhe ekzekutuar nga UNOPS-i. Ky program ka filluar financimin e projekteve në Shqipëri që në vitin 1998 dhe ka financuar gjithsej 231 projekte.

Në fund të takimit organizatorët falënderuan dhe siguruan pjesëmarrësit se të gjitha komentet dhe mendimet e shprehura në këtë takim përmbyllës, do të pasqyrohen në variantin përfundimtar, i cili pasi të jetë miratuar, do të bëhet publik shumë shpejt.



Tryezë Konsultative "Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes së Kuvendit të Shqipërisë, një Fokus në Transparencën Parlamentare"
Tiranë, 18 maj 2016



Në ambientet e Kuvendit të Shqipërisë, nën kujdesin e Kryetarit të Kuvendit, z. Ilir Meta u zhvillua tryeza konsultative me temë "Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes së Kuvendit të Shqipërisë, një Fokus në Transparencën Parlamentare".

Aktivitetin e përshëndeti Kryetari i Kuvendit z. Ilir Meta duke vlerësuar rolin e publikut në vendimmarrjen e këtij institucioni, e cili ndikon në mënyrë direkte në veprimtarinë e tij.

Kreu i Kuvendit konfirmoi se institucioni i Kuvendit do të jetë gjithnjë një institucion i hapur dhe gjithëpërfshirës dhe me një administratë efektive.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin Ambasadori i OSBE-së, z. Florian Rauning; Nënkryetarët e Kuvendit, znj. Valentina Leskaj dhe z. Edmond Spaho; Ministria e Shtetit për Marrdhëniet me Parlamentin, znj. Ermonela Felaj; Deputetë; përfaqësues të trupit diplomatik të akredituar në vendin tonë; përfaqësues nga AMSHC-ja dhe shoqëria civile si dhe përfaqësues të medias etj.

Këtë tryezë e përshëndeti dhe Ambasadori i OSBE-së, z. Florian Rauning, i cili vlerësoi maksimalisht bashkëpunimin me institucionin e Kuvendit për një sërë aktivitete të

përbashkëta me pjesëmarrjen e të gjitha forcave politike. Ai theksoi se kemi organizuar 14 Forume, kemi mbështetur Aleancën e Grave Parlamentare, Ditën e Hapur të Kuvendit, kemi kontribuar për ndërtimin e urave të bashkëpunimit midis Kuvendit dhe Shoqërisë Civile, kemi trajnuar një grup trajnerësh si dhe kemi hapur dy zyra pilot në dy qarqe të vendit.

Më tej fjalën e mori Sekretarja e Përgjithshme e Kuvendit, znj. Albana Shtylla, e cila prezantoi Raportin Vjetor 2015 mbi Pjesëmarrjen e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes dhe konkretisht analizoi tema të tilla si pjesëmarrja e publikut në Komisionet Parlamentare, në Seancat Plenare, transparenca parlamentare etj. Znj. Shtylla vlerësoi në këtë takim pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile, grupeve të interesit dhe medias si një mundësi për të shkëmbyer mendime dhe ide në interes të qytetarit.

Më pas, tryeza vazhdoi me diskutime nga të pranishmit në funksion të përmirësimit të bashkëpunimit midis Kuvendit, Organizatave të Shoqërisë Civile, medias dhe publikut.

Në fund të takimit u bënë dhe një sërë rekomandimesh për të përmirësuar bashkëpunimin me shoqërinë civile në të ardhmen.

Tryezë e rrumbullakët "Administrata vendore pas zgjedhjeve – sfidat e riorganizimit" Tiranë, 24 maj 2016

Në ambientet e Kryeministrisë, në kuadër të iniciativave publike të pjesëmarrësve të Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike, u organizua aktiviteti në formën e një tryeze të rrumbullakët me politikë bërës, përfaqësues të qeverisjes vendore, ekspertë, përfaqësues nga AMSHC-ja si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Aktiviteti u përshëndet nga z. Enea Hoti, këshilltar i Ministrit për Çështjet Vendore si dhe z. Artan Shkëmbi, drejtor i përgjithshëm i Agjencisë së Zbatimit të Reformës Territoriale.

Gjatë këtij aktiviteti u diskutua lidhur me reformën administrative-territoriale, e cila synon uljen e kostove administrative dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve, bazuar mbi gjetjet dhe rekomandimet e një punimi kërkimor të përgatitur nga grupi organizator.

Debati i hapur i pjesëmarrësve pati si qëllim analizimin e efikasitetit të kësaj reforme të re me synim nxitjen e një brezi të udhëheqësve të rinj politikë dhe shoqërisë civile, të dedikuar për implementimin e modeleve më të mira demokratike të qeverisjes dhe zhvillimit.

Shembull i efikasitetit të kësaj reforme u analizua Bashkia Fier.

Të pranishmit vlerësuan iniciativën e pjesëmarrësve të Shkollës për të studiuar këtë temë mjaft të rëndësishme dhe theksuan se është e nevojshme që shembujt pozitivë dhe problemet që mund të jenë shfaqur pas zbatimit të reformës të trajtohen me vëmendjen e duhur dhe me përfshirjen e të gjithë aktorëve të shoqërisë.

Gjatë diskutimeve u dhanë një sërë mendimesh dhe sugjerime nga ekspertë dhe përfaqësues të grupeve të interesit, të cilat do të përmbledhen në një dokument, i cili do t'i ofrohet zyrtarisht institucioneve shqiptare dhe përfaqësive të huaja diplomatike në vendin tonë, me qëllim

krijimin e një ideje më të qartë të situatës aktuale dhe nxitjen e një dialogu publik gjithëpërfshirës mbi problematikat dhe gjetjen e zgjidhjeve.



**Event ne kuadër të projektit "STAR - Një shembull i shkëlqyer bashkëpunimi"
Tiranë, 26 maj 2016**

Në ambientet e Galerisë Kombëtare të Arteve, në kuadër të projektit "STAR - Një shembull i shkëlqyer bashkëpunimi", u organizua një aktivitet me përfaqësues të qeverisjes qendrore dhe vendore, ekspertë të fushës, përfaqësues të donatorëve të huaj, përfaqësues nga AMSHC-ja si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Aktiviteti u përshëndet nga z. Bledi Çuçi, Ministër Shteti për Çështjet Vendore, z. Johan Ndisi, i Ngarkuar me Punë në Ambasadën e Suedisë në Tiranë, znj. Rajmonda Balili, Kryetare e Bashkisë Patos si dhe z. Erion Veliqaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë.

Gjatë këtij aktiviteti u diskutua lidhur me reformën administrativo-territoriale, efikasitetin e kësaj reforme, e cila synon uljen e kostove administrative dhe rritjen e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Eventi pati si qëllim analizimin e modeleve më të mira demokratike të qeverisjes vendore në funksion të zhvillimit të vendit. Si shembull i efikasitetit të kësaj reforme u analizua Bashkia Tiranë dhe Patos.

Të pranishmit vlerësuan arritjet e kësaj reforme si mjaft të rëndësishme dhe theksuan se është e nevojshme që shembujt pozitivë si dhe problemet që mund të jenë shfaqur pas zbatimit të reformës të trajtohen me vëmendjen e duhur dhe me përfshirjen e të gjithë aktorëve të shoqërisë.

Takimi u përfundoi me një shfaqje dixhitale të rrugëtimit të Reformës Administrativo-Territoriale, kontribut i projektit "STAR".



Konferenca: "Roli i Shoqërisë Civile në Reformën e Administratës Publike - Standardet dhe Praktikët e BE-së" Prishtinë (Kosovë), 6 - 8 qershor 2016

Përfaqësuesi i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), z. Erion Banushi mori pjesë në konferencën "Roli i Shoqërisë Civile në Reformën e Administratës Publike - Standardet dhe Praktikët e BE-së", e cila u mbajt në Prishtinë, nga data 6 - 8 qershor 2016, nga projekti TACSO dhe i financuar nga Bashkimi Evropian.

Qëllimi i kësaj konference ishte mbledhja së bashku e rreth 80 pjesëmarrësve nga shoqëria civile, institucionet evropiane dhe autoritetet kombëtare nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë për të ndarë përvojat dhe idetë në lidhje me Parimet e Administratës Publike dhe Udhëzimet e KE për Mbështetjen që Shoqëria Civile në Vendet Kandidate.



AMSHC shpall listën e projekteve fituese të Thirrjes Nr. 9

Tiranë, 15 qershor 2016

AMSHC falenderon të gjithë përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile për interesimin e shprehur me projekt-propozime në kuadër të kësaj thirrje.

Për më shumë vizitoni online faqen zyrtare: www.amshc.gov.al

Takimi i parë i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC)

Tiranë, 23 qershor 2016

Pas përfundimit të procesit të verifikimit të votave dhe shpalljes së listës emërore me anëtarët e zgjedhur nga organizatat e shoqërisë civile për Këshillin Kombëtar për Shoqërisin Civile (KKSHC), u zhvillua takimi i parë i KKSHC-së në ambientet e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.



Takim i Komitetit të Përbashkët Teknik Prevezë (Greqi), 16 qershor 2016

Si pjesë e Komitetit të Përbashkët Teknik (Joint Technical Committee - JTC), përfaqësuesi i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), z. Ferhat Aga, mori pjesë në takimin e organizuar në zonën e Prevezës, Greqi në kuadër të ditëve informuese mbi Thirrjen Nr. 2 për Projekt-Propozimet.

Këto projekt-propozime fokusohen në funksion të bashkëpunimit ndërkufitar IPA Cross Border Programme Greqi-Shqipëri 2014-2020.

Në takim u komunikua lidhur me mënyrën e aplikimit, kriteret dhe specifikimet e linjës buxhetore.

Në takim morën pjesë përfaqësues të Shoqërisë Civile të të dy shteteve, por edhe përfaqësues të Qeverisë.



**Vizitë studimore "Përfshirja e Shoqërisë Civile në Vendimmarrje - Modeli i Estonisë"
Talin (Estoni), 27 - 30 qershor 2016**

Në kuadër të komponentit për mundësimin e mjedisit të Udhëzimeve për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit për periudhën 2014-2020, TACSO Albania dhe TACSO Serbia organizuan një vizitë studimore për përfaqësuesit e Bordit Mbikëqyrës, Drejtorit Ekzekutiv dhe stafit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) - Shqipëri, institucionet publike në Serbi përgjegjëse për shoqërinë civile dhe OSHC-të që punojnë për këtë çështje.

Vizita studimore fokusohet në njohjen e strategjive, mekanizmave dhe modeleve të bashkëpunimit për përmirësimin e mjedisit mundësues për OSHC-të në Estoni, bashkëpunimi Shoqëri Civile - Publik si dhe financimi publik për shoqërinë civile.



**Takim i Komitetit të Përbashkët Teknik
Follorinë (Greqi), 7 korrik 2016**



Si pjesë e Komitetit të Përbashkët Teknik (Joint Technical Committee - JTC), përfaqësuesit e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), z. Ferhat Aga dhe z. Andi Luga, morën pjesë në takimin e organizuar në zonën e Follorinës, Greqi në kuadër të ditëve informuese mbi Thirrjen Nr. 2 për Projekt-Propozimet.

Këto projekt-propozime fokusohen në funksion të bashkëpunimit ndërkufitar IPA Cross Border Programme Greqi-Shqipëri 2014-2020.

Në takim u komunikua lidhur me mënyrën e aplikimit, kriteret dhe specifikimet e linjës buxhetore.

**Takim i Komitetit të Përbashkët Teknik
Korfuz (Greqi), 13 korrik 2016**



Si pjesë e Komitetit të Përbashkët Teknik (Joint Technical Committee - JTC), përfaqësuesit e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) z. Andi Kananaj - Drejtor Ekzekutiv dhe z. Ferhat Aga - Specialist për Grantet e Zhvillimit të Shoqërisë Civile, morën pjesë në takimin e organizuar në Korfuz, Greqi në kuadër të ditëve informuese mbi Thirrjen Nr. 2 për Projekt-Propozimet. Këto projekt-propozime fokusohen në funksion të bashkëpunimit ndërkufitar IPA Cross Border Programme Greqi-Shqipëri 2014-2020.

Tryezë e rrumbullakët me donatorë vendas dhe të huaj

Tiranë, 15 korrik 2016

Në ambientet e Delegacionit të BE-së, ABA Business Center, me iniciativën e z. Stefano Calabretta, Menaxher Programi për Shoqërinë Civile, BE dhe znj. Claudia Vollmer, Shefe e Departamentit të Demokratizimit, pranë OSBE-së, u organizua një takim me donatorët vendas dhe të huaj, që kontribuojnë në sektorin e shoqërisë civile si dhe Grupin Lokal Këshillimor (GLK/LAG) të Projektit TACSO në Shqipëri.



Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, institucioneve qeveritare si dhe të institucioneve donatore ndërkombëtare, që ndihmojnë në zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri. Gjatë pjesës së parë të takimit u diskutua dhe u vuri theksi mbi funksionin këshillimor që ka GLK, i cili ofron këshillim mbi mjedisin ligjor dhe institucional për të mundur funksionimin e suksesshëm të OSHC-ve, nevojat dhe prioritetet e ngritjes së kapaciteteve si dhe përballimin e të gjitha sfidave me të cilat përballen OSHC-të.

Pjesëmarrësit prezantuan, gjithashtu, punën e bërë deri tani në ndihmë të OSHC-ve dhe veçanërisht përfaqësuesit e AMSHC-së vunë theksin te puna e madhe e bërë nga AMSHC dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, me ndihmën e madhe të përfaqësuesve të zyrës së BE-së, në konstituimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Më tej takimi vazhdoi me prezantimin nga të gjithë donatorët të sukseseve të arritura nga projektet e financuara prej tyre për periudhën 2014-2016 si dhe synimet për të ardhmen.

Nis projekti PERFORM për financimin e hulumtimeve në shkencat sociale

Tiranë, 20 korrik 2016



Ambasadori zviceran Christoph Graf dhe Ministria e Arsimit Lindita Nikolla nënshkruan marrëveshjen mbi zbatimin e programit PERFORM, program i cili nxit shkencat sociale në Shqipëri. Qeveria zvicerane jep gati 2 milion Euro për financimin e studimeve në shkencat sociale. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe një përfaqësues i AMSHC-së.

PERFORM do të zbatohet në Shqipëri dhe Serbi dhe do të financojë propozime për hulumtime dhe studime të cilat mund të kenë vlerë për vendimet në dobi të publikut. Lidhja midis politikave dhe shkencave sociale është e brishtë ndërkohë që evidencat dhe rekomandimet e ekspertëve në shkencat sociale do të ishin të dobishme për vendimet që marrin autoritetet dhe institucionet publike. Ky program do të synojë të bëjë studimet dhe gjetjet nga hulumtuesit të disponueshme dhe do t'i ofrojë ato për si evidencë për politikën dhe vendim-marrje. Gjithashtu, debatet publike mbi shumë çështje do të mund të informohet nga hulumtimet e kryera në fushat e shkencave sociale.

Përfituesit kryesorë nga ky program do të jenë universitetet, institutet e kërkimit, organizatat jo fitimprurëse dhe akademikët.

**Debati vjetor: "Ngritja e standardeve, rënie trendesh?
Mjedisi mundësues për shoqërinë civile në vendet e zgjerimit"
Bruksel (Belgjikë), 7 shtator 2016**

Rrjeti i Zhvillimit të Shoqërisë Civile në Ballkan organizoi debatin vjetor "Ngritja e standardeve, rënie trendesh? Mjedisi mundësues për shoqërinë civile në vendet e zgjerimit", i cili u zhvillua në Pallatin "Residence", Bruksel.



Ky aktivitet u organizua me rastin e prezantimit të Raportit Rajonal të Matricës së Monitorimit për vitin 2015, në të cilin u mblodhën përfaqësues të OSHC-ve nga Ballkani Perëndimor dhe Turqia për të paraqitur sfidat kryesore të mjedisit mundësues për shoqërinë civile në vendet e tyre.

Qëllimi ishte për të ngritur një diskutim me Komisionin, institucionet e tjera të BE-së dhe palët e interesuara se si procesi i pranimit në BE mund të nxisë një shoqëri civile të fortë dhe më të fuqizuar, që rrit përgjegjshmërinë politike dhe nxit të kuptuarit më të thellë të reformave për anëtarësim përpara publikimit të Paketës së Zgjerimit dhe Progres Raportet e Vendeve për 2015-2016.

Gjetjet e prezantuara janë bazuar në një monitorim të gjerë të kryer nga anëtarë dhe organizatat e BCSDN-së nëpërmjet mjeteve të zhvilluara bashkërisht - Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile mbështetur nga Komisioni Evropian dhe Balkan Trust for Democracy.

**Pjesëmarrje në aktivitetin "Running for Cooperation"
Kristalopigi (Greqi), 25 shtator 2016**

Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, morën pjesë në aktivitetin me titull "Running for Cooperation", zhvilluar në kuadër të "European Cooperation Day 2016" të Programeve IPA Cross-Border Greqi-Shqipëri. Në këtë aktivitet morën pjesë rreth 100 pjesëmarrës, përfaqësues të institucioneve publike nga pala greke dhe ajo shqiptare.

Qëllimi i kësaj iniciative konsiston në heqjen e barrierave kufitare ndërshtetërore si dhe miqësinë mes dy vendeve fqinjë. Gara e vrapimit u zhvillua nga Kristalopigi (Greqi) deri në Billisht (Shqipëri), ku rekordi që u shënuar ishte rreth 38 minuta për meshkuj dhe 47 minuta për femra.



**Pjesëmarrje në festivalin ndërkombëtar "KABA Festival"
Korçë, 10 – 12 tetor 2016**



Përfaqësues të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, morën pjesë në festivalin ndërkombëtar "KABA Festival", i cili u organizua në datat 10-12 shtator 2016 në qytetin e Korçës.

Në këtë event, të ftuar ishin artistë shqiptarë por edhe të huaj duke harmonizuar në këtë mënyrë edhe meloditë e artit edhe kur ky është i ndryshëm. Pjesëmarrja ishte e gjerë duke zhvilluar edhe më tej qëllimin e këtij event, i cili kryesisht fokusohet në ndërthurjen artistike të kulturave të ndryshme.

Ky projekt është financuar edhe nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) në kuadër të Thirrjes Nr. 9.

**Fushatë sensibilizuese “Dhuro flokë, fal shpresë!”
Tiranë, 15 tetor 2016**



Në kuadër të Muajit Ndërkombëtar të Ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit, shoqata “Europa Donna Albania” organizoi pranë parkut “Rinia”, fushatën një-ditore të dhurimit të flokëve për gratë e prekura nga kjo sëmundje. Flokët e dhuruara do të shndërrohen më pas në paruke të personalizuar për pacientet që i dëshirojnë ato. Parukierë të njohur kontribuan vullnetarisht në realizimin e kësaj nisme.

Për të përkrahur kauzën, të pranishëm në aktivitet ishin gra e vajza si dhe përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC).

Në hapje të aktivitetit “Dhuro flokë, fal shpresë”, drejtuesja e kësaj organizate, Donjeta Zeqa shprehu emocionet për këtë nismë duke ndarë me të gjithë të pranishmit edhe historinë e saj familjare. Në këtë aktivitet u përcollën mesazhe sensibilizuese nga personalitetet e njohura si Lajla Përnaska, Fiori Dardha, Irma Libohova, Jona Dervishi si edhe nga pacientë, të cilët ia kanë dalë të mposhtin me sukses sëmundjen.



WOMEX 16 (World Music Expo)

Santiago de Compostela, Galicia (Spanjë), 19 - 23 tetor 2016



Kryetari i Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së, z. Adrian Thano dhe Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së, z. Andi Kananaj morën pjesë në eventin WOMEX (World Music Expo), i cili u zhvillua në qytetin e vjetër Santiago de Compostela, Spanjë, të organizuar nga Ballkan World Music Management.

WOMEX (World Music Expo) është event i botëror muzikor më i veçantë, është një panair, festival botëror i muzikës, konferencë profesionale, shfaqje e filmave dokumentarë të muzikës, ceremoni e ndarjes së çmimeve dhe Samiti i DJ, i cili kombinon familjarizimin lokal me horizontin global.

Ky event pesë ditor ndihmon në njohjen multikulturore të shteteve pjesëmarrëse, në shkëmbimin e praktikave më të mira në ndihmë dhe mbështetje të kulturës vendase, bazuar kjo në eksperiencat e mëparshme të këtij event.

Trajnim për aplikantët e mundshëm për projekte në IPA 2014-2020

Pogradec, 20 - 21 tetor 2016



Përfaqësues të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) morën pjesë në trajnimin dy-ditor për aplikantët potencialë në Thirrjen e parë për propozime në kuadër të Programit IPA II CBC Maqedoni - Shqipëri, i cili u mbajt në Pogradec.

Objektivi kryesor i këtij aktiviteti është rritja e kapaciteteve të aplikantëve potencialë për të aplikuar me projekte cilësore në kuadër të IPA 2014-2020. Temat kryesore të trajnimit ishin lidhur me përgatitjen e një projekt ideje, plotësimin e aplikimit, buxhetimin, kornizën logjike, etj.

Brukseli bën thirrje për të mbështetur shoqërinë civile të Ballkanit

25 nëntor 2016



Rrjeti për Zhvillimin e Shoqërisë Civile të Ballkanit (BCSDN) në një raport të ri, i ka bërë thirrje Komisionit Evropian për të thelluar angazhimin e tij për grupet dhe iniciativat e shoqërisë civile në rajonin e Ballkanit.

Rrjeti për Zhvillimin e Shoqërisë Civile të Ballkanit, BCSDN, në raportin e tij të fundit, thotë se organizatat e shoqërisë civile në vendet e Ballkanit janë në një pikë kritike sa i përket iniciativave të tyre në fushat kyçe të tilla si, liria e medias, sundimi i ligjit dhe anti-korrupsioni.

Raporti i bëri thirrje Komisionit Evropian që të "vazhdojë mbështetjen e tij për nismat kritike dhe strategjike kombëtare dhe rajonale të shoqërisë civile, që e kanë ndihmuar atë për t'u zhvilluar dhe formuar."

Raporti i BCSDN, i cili analizon progres raportet e fundit të Komisioni për vendet e Ballkanit, thekson se BE-ja kishte "vërejtur ritmin në rënie të reformave, një prirje drejt autoritarizmit dhe një situatë të paqëndrueshme ekonomike në vendet në zgjerimit", ndërkohë që ju kishte ngarkuar një rol të rëndësishëm organizatave shoqërisë civile si "shtyllë e katërt" e demokracisë në Ballkan.

Megjithatë, BCSDN ka deklaruar se Komisioni nuk kishte adresuar problemin që këto organizata "ende nuk kanë shumëfishuar mjaftueshëm financimin e tyre, duke mbetur tepër të varur në financimet publike të kufizuara dhe në fondet e huaja".

"Duke pasur parasysh mungesën e përparimit të konsiderueshëm në

procesin e reformës strukturore në të gjitha vendet dhe paqëndrueshmërinë politike, duke siguruar mjedis për rritjen e sulmeve dhe presionit mbi aktivistë të shoqërisë civile dhe organizatave të shoqërisë civile, Komisioni do të duhet të nxisë më tej dhe më lartë, që të dyja këto", ka thënë ai.

Rrjeti i bëri thirrje Komisionit që në raportet e tij të ardhshëm në vitin 2018, të "sigurojë përparim të qartë (ose mungesën e tij) rreth objektivave të Udhëzuesit për Shoqërinë Civile të BE-së për të treguar rezultate konkrete dhe arritje në lidhje me Udhëzuesin si dhe përshtatjet e nevojshme në rrugën përpara drejt vitit 2020".

Rrjeti për Zhvillimin e Shoqërisë Civile të Ballkanit, BCSDN, shkruan se Komisioni ka vërejtur probleme të shumta me të cilat përballen aktivistët dhe organizatat e shoqërisë civile.

Kufizime të lirisë së grumbullimit ishin raportuar sërish në këtë vit në Mal të Zi dhe Turqi, si dhe në Maqedoni. Ndërsa në Mal të Zi kjo ishte për shkak të kërcënimeve të aktivistëve të shoqërisë civile, liria e grumbullimit ishte tepër e kufizuar në Turqi si pjesë e masave të post-grushtit të Shtetit të marra nga Qeveria.

"Në Maqedoni këto janë vërejtur, duke pasur si objektiv shqyrtimin e hetimeve dhe shkelje të privatësisë nga ana e agjencive të zbatimit të ligjit, kur OSHC-të nuk ishin dakord me qeverinë për çështje të ndjeshme politike" shkroi BCSDN.

Përveç kësaj, Komisioni gjithashtu vërejt se aktivistët në Maqedoni, Mal të

Zi, Serbi dhe Turqi u përball me fushata diskreditimi të drejtuara nga mediet pro-qeveritare.

Në Maqedoni, aktivistët në lëvizjen anti-qeveritare "Colourful Revolution" u gjobitën dhe u dërguan në gjykatë pas mosbindjes civile gjatë protestave.

BCSDN ka vërejtur se, sipas Brukselit, organizatat e shoqërisë civile janë shumë të "varur nga numri i kufizuar i donatorëve dhe burimeve të tjera, duke penguar aftësinë e tyre për të bërë planifikime afatgjata si dhe për të punuar në mënyrë të pavarur".

Kjo ishte për shkak se në shumicën e vendeve qeveritë kanë dështuar në krijimin e "kornizave dhe qasje transparente ndaj fondeve publike dhe shpërndarjes së tyre".

Ndërkohë që janë marrë hapa për të krijuar bashkëpunim më të mirë ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe shtetit në Shqipëri, Bosnjë dhe Serbi, duke krijuar organe shtetërore ose lokale, ose duke caktuar personalitete për të udhëhequr dialogun me OJQ-të, ka ende shumë vend në të gjithë rajonin për angazhimin e mëtejshëm të grupeve të shoqërisë civile në bërjen e politikave.

BCSDN ka deklaruar se Komisioni nuk kishte arritur të vërente se "Përfshirja e OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve në emër të shtetit nuk është i rregulluar dhe rrallë praktikohet".

Tryezë e rrumbullakët "Diskutim i Axhendës së 2013 për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile" Tiranë, 25 nëntor 2016



Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së, z. Andi Kananaj mori pjesë në tryezën e rrumbullakët për një mjedis mundësues për shoqërinë civile, të organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), e cila u mbajt në ambjentet e Hotel Tirana International.

Roli dhe angazhimi i shoqërisë civile mbetet thelbësor jo vetëm në rrugëtimin e vendit drejt BE-së, por edhe në të gjitha proceset zhvillimore në shoqërinë shqiptare.

Në dhjetor të 2013 një axhendë prioritare veprimi u dakordësua midis qeverisë dhe përfaqësuesve të OShC-ve në vend, por në kuadër të zgjedhjeve të ardhshme të përgjithshme të 2017, është me rëndësi të ri-vizitohet Axhenda e 2013, në një diskutim të hapur me aktorët kyç të zhvillimit të shoqërisë civile dhe aktorët e tjerë të interesit në Shqipëri.

Në këtë tryezë u vlerësua përvoja e viteve 2013-2016 për adresimin e prioriteteve për një mjedis mundësues dhe sfidat për përmbushjen e rezultateve, si dhe u shqyrtua adresimi i pjesës tjetër të Axhendës.

Në këtë takim u mbledhën aktorë të shoqërisë civile, komunitetit të donatorëve, përfaqësues të qeverisë dhe aktorë të tjerë politikë, në një forum diskutimi, advokimi dhe rrjetëzimi për të avancuar më tej zbatimin e Axhendës së 2013.

Kjo Tryezë u zhvillua në kuadër të projektit "Acquis e shoqërisë civile ballkanike - Fuqizimi i potencialit advokues e monitorues dhe kapaciteteve të OShC-ve", financuar nga Bashkimi Evropian, përmes Instrumentit të Ndhmës së Paraademit (IPA) dhe Instrumentit për Shoqërinë Civile (CSF) dhe zbatuar nga Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN), anëtare e së cilit është dhe IDM.



Takimi konsultues me Shoqërinë Civile mbi Raportin e vitit 2016 të Komisionit European për Shqipërinë Tiranë, 1 dhjetor 2016



Përfaqësuesi i AMSHC-së, z. Erion Banushi mori pjesë në takimin konsultues me Shoqërinë Civile mbi Raportin e vitit 2016 të Komisionit European për Shqipërinë, takim i cili u organizua nga Ministria e Integritimit European dhe u mbajt në Hotel Tirana International.

Takimin e drejtoi Zëvendësministrja e Integritimit European, Znj. Eralda Çani dhe të pranishëm ishin përfaqësues të Ministrisë së Integritimit European dhe përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile.

Zv. Ministrja, bëri një prezantim të gjetjeve dhe rekomandimeve të Raportit mbi 5 prioritetet, duke nënvizuar se pavarësisht progresit të bërë dhe rekomandimit pozitiv për çeljen e negociatave, ka ende shumë sfida të mëdha përpara.

Në takim u ngritën pyetje, u bënë komente dhe u mbajtën diskutime nga përfaqësuesit e shoqërisë civile lidhur me tematika të ndryshme sipas fushës së tyre të ekspertizës në lidhje me Raportin e KE-së për Shqipërinë.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile, u shprehën se informimi për procesin e integritimit në rrethe është ende i domosdoshëm për qytetarët. Sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile, qeveria duhet të jetë më favorizuese ndaj tyre dhe të organizohen më shumë trajnime dhe informime në kuadër të aplikimeve për fondet e BE-së.

**Çelet në Tiranë Zyra Rajonale për Bashkëpunimin Rinor, RYCO
Tiranë, 8 dhjetor 2016**



Në kuadrin e procesit të Berlinit dhe si pjesë e këtij angazhimi çelet në Tiranë Zyra Rajonale për Bashkëpunimin Rinor (ZRBR) mbi bazën e modelit frymëzues të bashkëpunimit rinor franko-gjerman.

AMSHC është një ndër financuesit e këtij projekti, i cili po implementohet nga Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim (CDI), me qëllim ofrimin e informacionit të detajuar dhe ndërgjegjësimin e të rinjve shqiptarë mbi këtë zyrë (RYCO); promovimi dhe rritja e aksesit në informimin e të rinjve dhe organizatave rinore në nismat dhe projektet që do të mbështesë kjo zyrë.

Promovimi i kësaj zyre u bë gjatë Konferencës së parë rajonale për bashkëpunimin rinor.



Konferenca Kombëtare:

“Përforcim të mëtejshëm për një mjedis mundësues më të mirë për Organizatat e Shoqërisë Civile në Shqipëri”

Tiranë, 13 dhjetor 2016



Përfaqësuesit e AMSHC-së, z. Andi Kananaj – Drejtor Ekzekutiv i AMSHC-së, i shoqëruar nga z. Erion Banushi - Përgjegjës i Sektorit “Zhvillimi i Projekteve” si edhe anëtarë të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) morën pjesë në Konferencën Kombëtare: “Përforcim të mëtejshëm për një mjedis mundësues më të mirë për Organizatat e Shoqërisë Civile në Shqipëri”, e organizuar nga zyra TACSO Albania, e cila u mbajt pranë ambjenteve të Hotel Tirana International.

Në këtë konferencë pati pjesëmarrje të lartë të 110 organizatave të shoqërisë civile, përfaqësues nga qeveria dhe partnerë që mbështesin aktivitetin e organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri.

Qëllimi i konferencës ishte për të inkurajuar një mjedis mundësues për OSHC-të në Shqipëri dhe për të forcuar bashkëpunimin me institucionet publike për përmirësimin e mëtejshëm të legjislatonit ligjor dhe fiskal, rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të strukturave dhe mekanizmave institucionale midis të dy sektorëve.

Gjatë hapjes së konferencës, ambasadorja e BE-së, znj. Vlahutin theksoi nevojën vendimtare të një dialogu efektiv dhe sistematik midis institu-cioneve dhe shoqërisë civile në Shqipëri: institucionet duhet të tregojnë përkushtim politik në rritje dhe veprime konkrete në drejtim të forcimit të rolit të shoqërisë civile, kapacitetet dhe mjedisi dhe shoqëria civile duhet të ushtrojë si qytetarinë e saj aktive ashtu edhe rolin mbikëqyrës.

Në konferencë, ambasadorja e BE-së, znj. Romana Vlahutin gjithashtu u shpreh se vendi është në mes të reformave shumë të rëndësishme dhe është thelbësore që zëri i qytetarëve në Shqipëri është shumë më i fortë.

Pjesëmarrja e qytetarëve është thelbësore që demokracia të jetë funksionale.

Kjo konferencë adresoi mesazhe të rëndësishme për përfaqësuesit e qe-verisë dhe solli në fokus rëndësinë e dialogut si mënyra për të zgjidhur çështjet problematike të barrave të panevojshme burokratike, taksat e papërshtatshme dhe detyrimet fiskale, të raportimit financiar të rënduar dhe mungesa e stimuljeve për donacione dhe / ose filantropi nga korporatat dhe individët.

Lista e konkrete e propozimeve fiskale dhe ndryshimet do t'i paraqitet Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe Ministrisë së Financave.

Event social "Chill & Chat"

Tiranë, 14 dhjetor 2016

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) në bashkëpunim me "Hemingway Fun Club Albania", orga-nizuan eventin social "Chill & Chat", në ambjentet e "Hemingway Fun Club Albania" në orën 19:00.

Në këtë event morën pjesë Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së me stafin; përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, donatorë vendas dhe të huaj, të cilët bashkëbiseduan miqësisht mbi veprimtarinë e AMSHC-së për vitin 2016 si dhe sfidat dhe objektivat për vitin 2017 me fokus rritjen e kapaciteteve të OJF-ve në vend.

Gjatë eventit u paraqit një prezantim i shkurtër mbi aktivitetet social-kulturale të organizuara nga Shoqata kulturore "Hemingway Fun Club Albania".



AMSHC zhvillon takime konsultative në rrethe mbi përcaktimin e prioritetëve të Thirrjes Nr. 10

Dhjetor 2016

Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) zhvilluan takime konsultative me përfaqësues të Shoqërisë Civile në disa qytete të vendit, me qëllim marrjen e komenteve / sugjerimeve dhe ndihmesës të tyre mbi përcaktimin e prioritetëve të thirrjes së radhës si edhe të mënyrës së realizimit të saj.

Këto takimet konsultative u zhvilluan në qytetet: Kukës, Gjirokastrë, Pukë dhe Pogradec, përkatësisht në datat 14, 16, 20 dhe 23 dhjetor 2016.



Kukës, 14 dhjetor 2016



Gjirokastrë, 16 dhjetor 2016



Pukë, 20 dhjetor 2016



Pogradec, 23 dhjetor 2016